



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:**

**“Menaxhim Spitalor”**

**Universiteti “Western Balkans”**

### **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Lul RAKA**

**Prof. As. Gazment KODUZI**

Two handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the names. The top signature is for Prof. Dr. Lul RAKA, and the bottom signature is for Prof. As. Gazment KODUZI.

**Shtator / 2024**



**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Master i Shkencave në: “Menaxhim spitalor”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Western Balkans"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Menaxhim Spitalor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 514 datë 07.09.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023: 8 PAE / 1 PAK 2023-2024: 9 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 10 studentë 2023-2024 8 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Western Balkans (WB), është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 679 datë 11.11.2021 “Për hapjen e Institucionit të Arsimit të Lartë jo publik Universiteti “Western Balkans”. WB përbëhet nga tri fakultete:

1. Fakulteti i Mjeksisë Dentare;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
3. Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit;

Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor” është një program studimi që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit. Programi është licensuar sipas Urdhërit të MAS. Nr. 514, datë 07.09.2022 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor” në Universitetin “Western Balkans”. Ky program studimi përmban 120 ECTS dhe është i organizuar në 2 (dy) vite akademike (4 semestra), dhe ofrohet në gjuhën angleze.

Në përfundim të këtij program studimi lëshohet diplomë Master i Shkencave në: “Menaxhim Spitalor”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Fakulteti është përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e programit duke kontribuar tre departamentet dhe strukturat e tjera duke dhënë kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit. Në këtë fushë studimi Fakulteti ofron dhe programin Bachelor në Menaxhim i Kujdesit Shëndetsor.

Ky program ka si objektiv të ofrojë personel të trainuar në menaxhimin e institucioneve shëndetësore në përgjithësi, dhe të spitaleve në vecanti.

Gjithashtu, me rëndësi është mbushja e hapësirës boshe që ka sistemi ynë shëndetsor në mungesat e personelit të trainuar në fushën e menaxhimit shëndetsor dhe atij spitalor. Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor akreditohet për herë të parë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor” ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI), “Universiteti Western Balkans”. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të dytë Master i Shkencave pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. (ascal.al) Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.


Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 6 muaj. Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga **Prof.Dr. Lul Raka** dhe **Prof.As. Gazmend Koduzi**. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Majlinda Demireli. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UËB e zhvilluar në datat 28 dhe 29 Shkurt 2024. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e FETI. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm studentëve dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu GVJ vlerëson edhe mbështetjen e ASCAL në këtë proces të parë të realizuar për këtë program studimi. Nga ana tjetër shprehim bindjen se ky akreditim i parë, gjetjet dhe konstatimet në këtë raport, do ti vlejnjë institucionit të përmirësojë më tej programin e studimit.

Universiteti "Western Balkans" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.08.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 115/12 Prot, datë 27.08.2024. Universiteti "Western Balkans" njofton më datë 04.09.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 40 / 2, prot, datë 02.09.2024, " *Kthim përgjigje shkresës Nr. 115 / 12 Prot, datë 27.08.2024*", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Western Balkans”, është një institucion jopublik i arsimit të lartë, i licencuar në vitin 2021 me VKM nr. 679 datë 10.11.2021 “Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Universiteti “Western Balkans”. Institucioni ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politikëbërëse në fushën e shëndetësisë, ekonomisë dhe teknologjisë. Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti ekonomisë, teknologjisë dhe inovacionit (FETI) me kontribut të çdo njësie, strukture të fakultetit dhe universitetit në tërësi. Programi i studimit i ofruar nga FETI, është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit UMT.</p> <p>Evidenca nr 1.1. Statuti i Universitetit Western Balkans; Evidenca nr 1.2. Rregullore themelore WBU; Evidenca nr 1.3. Rregullore FETI; Evidenca nr 1.4. Plani Strategjik I Zhvillimit të WBU v.2023-2030;</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në “Menaxhim spitalor” është në përputhje me profilin që ka WBU. Spektrin e nevojave që kanë qendrat spitalore, shëndetësore publike e private në vend, për të punësuar menaxher shëndetësor. Programi i studimit i ofruar nga FETI është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit, e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t’u bërë ekspertë të denjë në fushën e menaxhimit spitalor. Bazuar në informacionin e dhënë, Programi synon edukim të studentëve, duke ruajtur dhe konsoliduar vlerat akademike e</p>

	<p>kulturore kombëtare në të njëjtën linjë me interesat kombëtare.</p> <p>Evidenca nr 1.1. Statuti WBU; Takimi me drejtuesit e FSHMT; Evidenca nr 1.3.Rregullorja e FETI;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>GVJ evidenton se programi i studimit Msc në menaxhim spitalor është hartuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren themelore të WBU, dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të institucionit. Përmbajtja e tij, është hartuar, përditësuar dhe përshtatur nevojave që ka vendi por njëkohësisht ka reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e menaxhimit spitalor. Misioni dhe qëllimi i programit të studimit është përgatitja e specialistëve të aftë të fushës së menaxhimit spitalor.</p> <p>Programi Msc në “Menaxhim spitalor” është vazhdim i programit bachelor në “Menaxhim dhe kujdes shëndetësor” që ka në focus orhganizimin dhe menaxhimin shëndetësor, në institucionet publike dhe private. Referuar dokumentacionit mbështetës, rezulton se programi ka objektiva të qarta që synojnë jo vetëm edukimin e specialistëve në menaxhimin shëndetësor për të shërbyer sa më mirë rrejtit shëndetësor vendas dhe jashtë tij, por edhe edukimin e tyre nga ana teorike, praktike dhe kerkimore-shkencore.</p> <p>Evidenca nr 1.4. Plani strategjik I WBU 2023-2030; Evidenca nr 1.2. Statuti I WBU; Evidenca nr 1.2. Rregullorja themelore e WBU;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, Strategjinë e zhvillimit institucional të WBU, Strategjinë kombëtare të punësimit dhe arsim, Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe informacionin si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së FETI.</p> <p>Evidenca nr 1.1. Stauti i WBU; Evidenca nr 1.4. Plani Strategjik 2023-2030;</p>



<b>Konkluzione</b>	<i>Fakulteti i ekonomisë, teknologjisë dhe informacionit ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, të përshkruara në Satutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të WBU, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Në të njëjtën linjë, edhe programi MSc. Menaxhim spitalor zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit të mjekësisë</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>			
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit MSc. në “Menaxhim Spitalor” është hartuar në përputhje me nevojat që ka vendi dhe tregu i punës duke përgatitur specialistë të menaxhimit spitalor. Sipas deklarimeve të drejtuesve, programet e studimit të ofruara nga WBU bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka rajoni dhe vendi. Referuar të dhënave në dispozicion, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, si njësi kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij, 25 personel akademik efektiv (PAE) i ndarë në tre njësi bazë, si:		
	<b>Njësia bazë</b>	<b>PAE</b>	<b>Tituj/Grada</b>
	Departamenti i Teknologjisë dhe Biznesit	<b>9</b>	1– Prof. Asoc. 4 – Dr. 2 - Dr. në Proc. 2- Msc
	Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës	<b>8</b>	2– Prof. Asoc. 4– Dr. 2 - Msc

	<table border="1"> <tr> <td>Qendra Kërkimore-Shkencore SMTI</td> <td>8</td> <td>1 – Prof. Asoc. 2 – Dr. 5 - Msc</td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>25</b></td> <td><b>25</b></td> </tr> </table>	Qendra Kërkimore-Shkencore SMTI	8	1 – Prof. Asoc. 2 – Dr. 5 - Msc	<b>Total</b>	<b>25</b>	<b>25</b>
Qendra Kërkimore-Shkencore SMTI	8	1 – Prof. Asoc. 2 – Dr. 5 - Msc					
<b>Total</b>	<b>25</b>	<b>25</b>					
	<p>Nga sa më sipër, GVJ gjykon se fakulteti ka kapacitetet e nevojshme dhe stafin e kualifikuar për të ofruar me cilësi programin e studimit Msc Menaxhim spitalor. Fakulteti ka burimet e duhura logjistike për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore, përmes laboratorëve dhe praktikave në spitale.</p> <p>Evidenca nr 1.5. Studimi I tregut të punës për hapjen e programit:</p> <p>Evidence nr. 4.1. Numri I personelit akademik per cdo njesi bazë:</p> <p>Evidence nr. 4.2 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit:</p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Universiteti Western Balkans ofron programe studimi në fushën e ekonomisë dhe mjekësisë. Bazuar në Statutin e WBU, Rregulloren themelore e WBU, Rregulloren e FETI, planin strategjik 2023-2030, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të WBU. Programi i studimit MSc. Menaxhim spitalor, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore fakulteti dhe institucioni. Programet e studimit në WBU, synojnë transmetimin e njohurive në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Programet synojnë edukimin dhe kualifikimin shkencor e profesional të studentëve në fushën e ekonomisë, teknologjisë dhe mjekësisë. Programi i studimit MSc. Menaxhim spitalor, përgatit studentët me njohuritë e avancuara në fushën e menaxhimit të institucioneve shëndetësore, vecanërisht atyre spitalore. Programi është organizuar dhe ofrohet në përputhje me udhëzimet dhe aktet nënligjore në fuqi. Programi i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe ka kodin e vet të përcaktuar nga ana e institucionit.</p> <p>Evidenca nr 1.1. Statuti WBU;</p> <p>Evidenca nr 1.2. Rregullorja themelore e WBU;</p>						

	Evidenca nr 1.3.Rregullorja e fakultetit te ekonomisë, teknologjisë dhe inovacionit;
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Edhe fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të ekonomisë, teknologjisë dhe inovacionit. Fusha e përgjithshme është ajo e menaxhimit e cila është fusha kryesore e institucionit ndërsa fusha specifike lidhet me menaxhimin spitalor. GVJ konstaton se referuar procedurës së ndjekur nga ana e institucionit për klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, ato janë në përputhje me aktet e miratuara dhe ISCED.  Evidenca nr 1.1. Statuti WBU; Evidenca nr 2.1. Rregullore e programeve të ciklit të dytë; Evidenca nr 3.1. Silabuset e lëndëve;
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N / A
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Universiteti Western Balkans ofron programe studimi të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të diplomuarit në këtë institucion. Megjithëse institucion i ri, WBU ka kryer trainime për personelin apo studentët e diplomuar. Trainimi i vazhduar në WBU, sidomos në menaxhim spitalor, ndihmohet edhe nga fakti që është pjesë e grupit spitalor American Hospital.  Evidenca nr. 1.9. Lista e trainimeve të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023;
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ gjykon se fakulteti ka kapacitetet e nevojshme dhe stafin e kualifikuar për të ofruar me cilësi programin e studimit MSc. Menaxhim spitalor. Programi i studimit Master shkencor Menaxhim spitalor, përgatit studentët me njohuritë e nevojshme si dhe aftësitë profesionale në fushën e menaxhimit spitalor. GVJ konstaton se procedura e klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, ato janë në përputhje me aktet e miratuara dhe ISCED</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda WBU dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësive mes njësisë kryesore, njësisë baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statuti rregullor e WBU, rregullor e programit të studimit, dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi.</p> <p>Programi i studimit Msc në Menaxhim spitalor ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të shkencave ekonomike dhe financës, pjesë e Fakultetit të ekonomisë, teknologjisë dhe inovacionit, që mbikqyr mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore në këtë program, si dhe kordinimin duke bashkëpunuar me drejtuesit e njësive bazë , në përputhje me rrgulloren dhe statutin e WBU.</p> <p>Evidenca nr 1.1. Statuti I WBU;</p> <p>Evidenca nr. 1.3. Rregullorja e Fakultetit të ekonomisë, teknologjisë dhe inovacionit;</p> <p>Evidenca nr. 1.10. Rregullorja mbi organizimin akademik të UËB:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë</p>	<p>GVJ konstaton se WBU ka një rrjet bashkëpunorësh të gjërë brenda dhe jashtë vendit. Rendësi në zhvillimin e programit ka marrëveshja e bashkëpunimit me Shoqerinë American Hospital Sh.A dhe International Hygea Hospital Sh.A dhe Cambridge Vlinical Laboratories. Marrëveshjet me këto grupe spitalore krijojnë mundësinë e praktikave profesionale dhe mësimore, si dhe mundësinë e punësimit.</p> <p>Evidenca nr 1.7.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimeve të ËBU;</p>

vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.									
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<p>Në takimin me drejtuesit dhe personelin akademik, u evidentua se FETI ka avantazh të madh në mundësitë që u oforhen studentëve në zhvillimin e praktikave profesionale si pasojë e bashkëpunimit të ngushtë me institucione spitalore. Përveç strukturave spitalore, avantazh përbën fakti që pjesë e stafit janë edhe persona që punojnë në institucione spitalore dhe jo vetëm sjellin përvojën e tyre, por ndihmon edhe në praktikat mësimore. WBU është pjesë e programit EPIC (Education Practice Integration Curriculum) përmes të cilit ofron intership të paguar për studentët pranë institucioneve partnere.</p> <p>Evidenca nr 1.7. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimeve të ËBU;</p> <p>Evidenca nr. 1.14 Lista e marrëveshjeve për EPIC;</p> <p>Evidenca nr. 1.15. Manualët e praktikave EPIC;</p>								
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Departamenti si njësia përgjegjëse e këtij program studimi evidenton nëpërmjet raporteve periodike të analizës vjetore përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretet që reflektohen në analizën vjetore të departamentit.</p> <p>Evidenca nr. 1.20. raporti vjetor I analizës së punës kërkimore-shkencore I e Departamentit të shkencave ekonomike dhe financave për vitin akademik 2022-23;</p>								
<b>Konkluzione</b>	<i>FETI ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore dhe spitalore vendase dhe të huaja, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. GVJ e konsideron si pikë të fortë nivelin e bashkëpunimit institucional dhe të programit me institucionet spitalore, veçanërisht në zhvillimin e praktikave profesionale dhe hulumtimeve shkencore që kryejnë studentët gjatë zhvillimit të temave të diplomave.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor është hapur me urdhër të MAS Nr. 514, datë 07.09.2022 Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është i organizuar me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik (4 semestra), në gjuhën angleze dhe kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome “Master i Shkencave” në “Menaxhim Spitalor”. Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë 12 ECTS (10%);</li> <li>- Lëndë karakterizuese 60 ECTS (50%);</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 24 ECTS (20%);</li> <li>- Lëndë plotësuese 12 ECTS (10%);</li> <li>- Detyrime përmbyllëse dhe diploma 12 ECTS (10%);</li> </ul> <p>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive nga A - E në ECTS/ përqindje përputhet me ato të parashikuara në VKM nr 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Evidenca nr. 2.2 Kurrikula e programit</p>

<p><b>Kriteri 2.</b>Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor, përmban një informacion të plotë në fushën e menaxhimit shëndetësor dhe në venci për menaxhimin spitalor. Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit që pas diplomimit të përshtatet me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë që ofrojnë njohuri që nga menaxhimi informacionit, menaxhimi burimeve njerëzore, financiar si dhe menaxhimi i pacientit.</p> <p>Njohuritë e fituara i shërbejnë studentit për përfitim e aftësive dhe kompetencave për të kryer në mënyrë të pavarur menaxhimin e njësisve shëndetësore të madhësive të ndryshme. Gjithashtu njohuritë e fituar në këtë program studimi shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme të doktoratës apo trajnimeve të tjera.</p> <p>Evidenca nr. 2.2 Kurrikula e programit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademik të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS nga të cilat 12 ECTS i përkasin praktikës profesionale, 12 ECTS detyrimeve përmbyllëse si punimit të diplomës. Praktika profesionale realizohet në institucionet shëndetësore me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi dhe mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën</p> <p>Evidenca nr. 2.2 Kurrikula e programit; Evidenca nr. 1.7. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të EBU; Evidenca nr. 2.1. Rregullorja e programit të ciklit të dytë;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b>Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin</p>	<p><b>Nuk i përket këtij programi</b></p>

<p>Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b>Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p><b>Nuk i përket këtij programi</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b>Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Menaxhim spitalor organizohet dhe financohet bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikë ne Shqipërisë” dhe aktet nënligjorë të këtij ligji. Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit si dhe kuotat e pranimit miratohen me vendim të senatit akademik të universitetit.</p> <p>Evidence nr. 2.1 Rregullorja e programit të studimit;</p> <p>Evidence nr. 5.5 Vendimi nr. 2 datë 12.04.2023 i BA per miratimin e kuotave të pranimit për programin MSH Menaxhim Spitalor;</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Menaxhim Spitalor organizohet dhe financohet bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjorë të këtij ligji. Ky program ofrohet vetëm nga Universiteti Western Balkans dhe nuk ofrohet nga IAL të tjerë në vend. Në intervistë me drejtuesit e institucionit referojnë që në dizenjimin e tij kanë marrë për referencë programme të ofruara nga universitete ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b>Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Referuar RVB programi i studimit Msc në Menaxhim Spitalor, i ofruar nga WBU ka kodin përkatës (72MS) dhe përmban 120 Kredite ECTS për dy vite (4 semestra) studimi. Kodi 04 sepse programi i studimit ka lidhje me biznes, administrim dhe juridik. Kodi 10 tregon biznes dhe administrim, ndërsa në kolonën 4 është shkronja A si identifikim i gjuhës angleze.</p> <p>Kodi i plotë i programit të studimit “Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor” është 72MS0410A. Bazuar në këtë, kryhet edhe kodifikimi i lëndëve të programit: psh HSM 103 Ligji, politikat dhe rregullat në shëndetësi.</p> <p>Evidenca nr. 2.2 Kurrikula e programit MSC në Menaxhim spitalor</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit programi Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor” nuk është program i përbashkët midis IAL-ve, jashtë apo brenda vendit por realizohet vetë nga WBU.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë Inovacionit dhe i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) me kohëzgjatje 2 vite akademik, të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS nga të cilat 12 ECTS i përkasin praktikës profesionale, 12 ECTS detyrimeve përmbyllëse si punimit të diplomës. Programi zhvillohet në gjuhën angleze dhe kohë të plotë studimi.</i></p> <p><i>Në përfundim të studimeve lëshohet diplome “Master i Shkencave” në “Menaxhim Spitalor”. Programi i studimit “Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor ” përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e</i></p>

	<i>programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>																					
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>																					
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																				
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi Msc në “Menaxhim Spitalor” zhvillohet në Departamentin e Shkencave Ekonomike dhe Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI). FETI është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë”. Autoritet drejtuese janë Dekani, Zv. Dekani dhe Drejtuesit e Njesisë Bazë. Në përberje të tij janë 3 njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës;</li> <li>• Departamenti i Teknologjisë dhe Biznesit;</li> <li>• Qendra Kërkimore Shkencore për Shkenca Mjekësore, Teknologji dhe Inovacion;</li> </ul> <p>si dhe Administratori Njesisë Kryesore.</p> <p>Në vitin akademik 2023-2024 Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit përfshin në strukturën e tij 38 anëtarë si personel akademik nga të cilët 25 anëtarë janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 13 anëtarë janë personel akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2"><b>Kualifikimi i stafit</b></th> <th colspan="2"><b>Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit</b></th> </tr> <tr> <th><b>PAE</b></th> <th><b>PAK</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>10</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>11</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>25</b></td> <td><b>13</b></td> </tr> </tbody> </table>	<b>Kualifikimi i stafit</b>	<b>Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit</b>		<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	Prof.Dr	-	-	Prof.Asoc	4	2	Dr/PhD	10	5	Msc	11	6	<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>13</b>
<b>Kualifikimi i stafit</b>	<b>Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit</b>																				
	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>																			
Prof.Dr	-	-																			
Prof.Asoc	4	2																			
Dr/PhD	10	5																			
Msc	11	6																			
<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>13</b>																			

	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni shikojmë se gjate 2 viteve të fundit Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës si njësi baze përgjegjëse e programit plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafin akademik duke pasur një numër të qëndrueshëm stafi, si më poshtë për vitet akademike:</p> <table border="1" data-bbox="608 546 1337 882"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>1</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>7</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Evidenca</b> nr 1.3 Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 4.5 Lista e stafit akademik sipas departamenteve;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.5: Lista e personelit asistent lektor, ndihmës akademik dhe administrative pranë programit të studimit;</p>	Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	Prof. Asoc.	1	-	2	-	Dr./PhD.	3	1	4	2	Msc.	4	-	2	5	<b>Totali</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>7</b>
Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr.	-	-	-	-																															
Prof. Asoc.	1	-	2	-																															
Dr./PhD.	3	1	4	2																															
Msc.	4	-	2	5																															
<b>Totali</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>7</b>																															
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia bazë ku realizohet ky program studimi ka angazhuar staf akademik dhe ndihmës akademik mësimor për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale. Stafi ndihmës akademik asiston pedagogët për realizimin e programit mësimor.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.5: Lista e personelit asistent lektor, ndihmës akademik dhe administrative pranë programit të studimit;</p>																																		
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë, programi i studimit ka të emëruar koordinatorin e programit të emëruar me vendim të drejtuesit të njësisë bazë. Koordinatorin e programit të studimit, caktohet në detyrë nga drejtuesi i departamentit që ofron programin e studimit. Koordinatorin e programit perzgjodhet nga personeli akademik i programit dhe ka të paktën gradën shkencore "Doktor i shkencave". Koordinatorin e programit të studimit mbështet planifikimin, bashkë rëndon dhe mbikëqyr vrapimtarinë e programit të</p>																																		

përputhje me objektivat e tij.	studimit që mbulon, për të siguruar pë nbushjen e misionit dhe objektive të programit. Evidenca nr. 2.1 Rregullore e programit të ciklit të dytë			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi Msc në Menaxhim Spitalor zhvillohet në Departamentin e Shkencave Ekonomike dhe Financës në FETI. Fakulteti është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Në përberje të tij janë 3 njësi bazë. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës ky zhvillohet ky program studimi ka angazhuar në programet e studimit staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo MSH dhe staf ndihmës akademik. Bazuar në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë, programi i studimit ka koordinatoren e programit të emëruar me vendim të drejtuesit të njësisë bazë. GVJ, shprehet se njësia kryesore dhe ajo baze përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit e vënë në dispozicion konstaton se Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore. Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit.  Evidence nr 2.1: Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë  Evidencë nr 2.2 Kurrikula e programit

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Msc në Menaxhim Spitalor, përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 2 vite akademike të ndara në 4 semestra, me 20 orë mësimi në javë. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 120 ECTS ose 3000 orë mësimore prej të cilave 1125 janë orë në auditor dhe 1875 orë jashtë auditorit. Plani mësimor përshin lëndet/ disipinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurikulare. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikës. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm në masën 80%. Një orë mësimore është 50 minuta.</p> <p>Evidence nr 2.1 Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë;</p> <p>Evidenca nr 2.6 Syllabusi model;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Studentet nëpërmjet planit mësimor dhe kuadrit rregullator të brendshëm, rregulloret e studimit në rang institucional, njësi kryesore/baze, dhe nivel programi kane informacionin e duhur që në procesin e pranimit, regjistrimit dhe zhvillimit të programit ashtu edhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kriteret specifike përzgjedhëse në pranime të vendosur me VKM.</p> <p>Evidenca nr 1.3 Rregullorja e FETI;</p> <p>Evidenca 12.1 Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë;</p> <p>Takimi me studentët;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet</p>	<p>Programi i studimit përmban informacionin lidhur me sylabuset që zhvillon në programin Msc në Menaxhim Spitalor. Sylabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë</p>

<p>lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>mësimore/ profesionale, ECTS përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse të detyruar dhe të rekomanduar. Programi ka rregullore për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse praktika profesionale është 135 orë në vitin e dytë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- syllabuset janë organizuar/ formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;</li> <li>- në disa syllabuse <u>titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor</u> sipas Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 59 “Kategoritë e personelit akademik”;</li> <li>- lektorët janë të gjithë të kategorisë Doktor shkencash;</li> <li>-formimi profesional i pedagogut përputhet me lëndën që zhvillon;</li> </ul> <p><u>Rekomandim</u></p> <p>-Rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe emërtimi nga kategoria “Professor”</p> <p><b>Evidenca nr 2.1</b> Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë:</p> <p><b>Evidenca nr 3.1</b> Syllabuset e lëndëve:</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Departamenti ku zhvillohet programi i studimit ka përshkruar procedurën për përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i syllabuseve dhe literaturës për çdo lëndë. Në këtë proces përfshihen dhe studentët të japin mendimin e tyre, si dhe mekanizma të përmirësimit të cilësisë në kuadër të NJSBC. Lëndët që kanë leksione të shkruara rishikohen çdo vit dhe leksionet arkivohen së bashku me syllabuset në formë hard copy dhe elektronike në departament dhe drejtorinë e standarteve dhe kurikulave.</p> <p><b>Evidence nr 1.3:</b> Rregullore e FETI;</p> <p><b>Evidence 2.2</b> Kurrikula e programit:</p>

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit.</i></p> <p><i>-Struktura e programit të studimit Msc në Menaxhim spitalor, përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41/2018.</i></p> <p><i>-Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 2 vite akademike të ndara në 4 semestra. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 120 ETC ose 3000 orë mësimore prej të cilave 1125 janë orë në auditor dhe 1875 orë jashtë auditorit. Plani mësimor përshin lëndet/ disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurikulare</i></p> <p><i>-Programi i studimit përmban informacionin lidhur me sylabuset që zhvillon në programin MSH në infermieri. Në disa sylabuse <u>titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor, lektorët janë të gjithë të kategorisë Doktorë i shkencash.</u></i></p> <p><i>-Institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.4</b></p>	
<p><b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</b></p>	<p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të Menaxhimit Spitalor të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Shpërndarja e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D, E që mundëson dhënie të njohurive të thelluara. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional</p>

	<p>të studentit, ku orët e praktikës mësimore përbëjnë 10% të totalit të krediteve.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2. Rregullorja e programit të ciklit të dytë:</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit MSc në "Menaxhim spitalor":</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit "Menaxhim spitalor", marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/ orë mësimore përputhet me profilin e programit MSH në "Menaxhim spitalor".</p> <p><i>Në vitin e parë</i> zhvillohen më shumë lëndë të formimit karakterizues dhe lëndë ndërdisiplinore 36 ECTS nga 60 ECTS). <i>Në vitin e dytë</i> zhvillohen më shumë lëndë të formimit karakterizues (24 ECTS). Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional. Studentët kanë mundësi të aftësohen me shprehitë profesionale praktike gjatë zhvillimit të praktikave mësimore në spitalet me të cilat WBU ka marrëveshje, si Spitali Amerikan, Spitali Hygea, etj.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit MSc në Menaxhim spitalor;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2 Rregullorja e programit të ciklit të dytë:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i pari i këtij lloji në Shqipëri, dhe kanë marrë modele të ngjashme ndërkombëtare psh në Angli. Raporti teori praktikë është në funksion të formimit profesional në përputhje me profilin e programit të studimit MSc në Menaxhim spitalor. Programi ka më shumë orë të punës individuale 1875 orë dhe punë në klasë 1135 orë.</p> <p>Takimit me stafin drejtues të FETI dhe stafin akademik;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit të MSc në Menaxhim Spitalor;</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, ndikojnë në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijojnë mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brenda dhe jashtë vëndit.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit të studimit të MSc në Menaxhim spitalor</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>FETI dhe njësitë bazë kanë një praktikë të mirë dokumentuar lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo sylabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar. Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekste mësimorë të pedagogëve të WBU apo literaturë ndërkombëtare. Tekset mësimore për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjëndet në fund të çdo syllabusi.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 3.1 Syllabuset e programit MSc në Menaxhim spitalor;</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e Menaxhimit spitalor, aftësimin profesional teorik dhe praktik. Në takimin me drejtues të institucionit dhe të departamentit u referua se FETI po punon për përditësimin e kurikulës.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2 Rregullorja e programit të studimit cikli I dytë; <b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit të studimit MSc në Menaxhim spitalor;</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive në Menaxhimin spitalor dhe thellimin e njohurive të përfutuara në këtë program studimit në kualifikime të mëtejshme apo ndjekje të doktoraturës.</p> <p>Lëndët/ modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitim e kompetencës profesionale për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.</p>

	<b>Evidenca nr 2</b> Rregullorja e programit të studimit cikli I dytë: <b>Evidenca nr 2.2</b> Kurrikula e programit të studimit MSc në Menaxhim spitalor;			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vëren se programi u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fushën e Menaxhimit spitalor të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit i jep rëndësi të veçantë formimit praktik profesional të studentit. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional. Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekste mësimorë të pedagogëve apo ajo ndërkombëtare. Lëndët/ modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitimin e kompetencës profesionale, për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	FETI cdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe për përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në këtë proces një vend të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me përfaqësues aktorë dhe faktorë të ndryshëm në fushën e kujdesit shëndetësor, International Hygea Hospital, Grupi i Spitaleve Amerikane. Institucioni gjithashtu merr parasysh edhe propozimet e studentëve që diplomohen, përmes një procedure të konsoliduar.  <b>Evidenca nr 1.5</b> Studimi I tregut të punës për hapjen e programit Msc në Menaxhim spitalor:  <b>Evidenca nr 2.7</b> Formulari I vlerësimit të programit të studimit nga studentët që diplomohen:
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime	Pjesë e rishikimit apo përditësimit të programit mësimor janë dhe propozimet e bëra nga studentët e programit të cilët janë

<p>studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>në proces ose ata që kanë mbaruar ciklin e studimit. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në Senatin akademik, NJSBC. Duke qënë pjesë e vendimarrjes ata ndikojnë dhe në përmirësim të programit të studimit.</p> <p>Institucioni përdor mekanizma të ndryshme për marjen e mendimit të studentëve për programin mësimor si plotësimi i përvitshëm pyetësorëve. Një anë pozitive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore (alumni). WBU ka edhe strukturën “Dekanati i studentëve” që ka në varësi edhe Alumni Office, që do funksionojë pas diplomimit të brezit të parë të studentëve.</p> <p><b>Evidenca</b> nr Statuti i Universitetit Ëestern Balkans, Neni 62; <b>Evidenca</b> nr 1.2 Rregullorja themelore e Universitetit Ëestern Balkans, Neni 47;</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Cdo vit akademik njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi bën rishikim, përditësim të kurikulave. Një vënd të rëndësishëm në këtë proces zënë instrumentat e vlerësimit të cilësisë për studentët si edhe industrisë ku janë të punësuar të diplomuarit, me të cilat bashkëpunon WBU.</p> <p>Programi i studimit MSc në Menaxhim spitalor është i ri, por mekanizmat janë të përcaktuar në rregulloret e tij.</p> <p><b>Evidenca</b> nr Statuti i Universitetit Ëestern Balkans; <b>Evidenca</b> nr 1.2 Rregullorja themelore e Universitetit Ëestern Balkans;</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vëren se Departamenti cdo fillim vitit akademik bën përditësim e programit të studimit dhe për përshtatjen e programit të studimit me kerkesat e tregut të punës. Institucioni përfshin në procesin e rishikimit të kurikulave studentët me anë të mekanizmvave të ndryshme si plotësimi i përvitshëm pyetësorëve, përfshirjen e përfaqësuesve të tyre në senatin akademik, NJSBC. Një anë pozitive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore si dhe punëdhënësit të tyre. Institucioni ka Dekanatin e studentëve dhe Alumni Office që vepron nën këtë dekanat, por që do fillojë të veprojë pas diplomimit të brezit të parë të studentëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Mastër i shkencave në “Menaxhim Spitalor” ka si objektiv kryesor formimin profesional dhe shkencor bashkëkohor të menaxherëve shëndetësorë të niveleve të ndryshme në sistemin shëndetësor. Gjithashtu, ngritja e kapacitetve të menaxhimit, planifikimit dhe administrimit shëndetësor, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të Western Balkans University 2023-2030, janë objektiva kryesorë të programit të studimit.  Evidenca nr 1.4 Plani strategjik I ËBU 2023-2030;
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Në Statutin e WBU theksohet që Njësia kryesore dhe njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin e mësimdhënies, aktiviteve dhe veprimtarive kërkimore shkencor duke respektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete të cilët bashkëbisedojnë më pedagogët dhe studentët për problematika të vecanta lidhur me menaxhimin shëndetësor. WBU bashkëpunon me Grupin e Spitaleve Amerikane dhe International Hygea Hospital për kryerjen e praktikave dhe edukimin profesional.  Evidenca nr 2.11 Planifikimi vjetor I aktiviteve kërkimore shkencore të njësisë bazë dhe asaj kryesore; Evidenca nr 1.1 Statuti I Universitetit Western Balkans; Evidenca nr 1.3 Rregullorja e FETI;
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Program i studimit i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfilltë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Studentët janë angazhuar në organizimin dhe pjesëmarrjen e tyre në ëorkshope, konferencave shkencore apo trainuese. Studentët janë pjesëmarrës në këto aktivitete me punimet e tyre.

	<p><b>Evidenca</b> nr 1.17 Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore;</p> <p><b>Evidenca</b> nr Raport mbi pjesmarrjen në konferencë mejsore;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.13 Plani I punës kërkimore shkencore I Departamentit;</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik u referua se institucioni WBU i mbështet financiarisht në realizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore Brenda dhe jashtë vendit. Vëmprimtaria kërkimore shkencore në WBU është e garantuar përmes Rregullores mbi Kërkimin Shkencor.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.17 Rregullorja mbi kërkimin shkencor;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.18 Model I mbështetjes financiare të personelit në pjesmarrje aktiviteti kërkimore shkencore;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.19 Udhëzim për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor;</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatonn se Njësia kryesore/ bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete të cilët bashkëbisedojnë më pedagogët dhe studentët për problematika të vecanta lidhur me menaxhimin shëndetësor. Institucioni mbështet financiarisht stafin akademik në aktivitetin kërkimor shkencor duke i përfshirë në projekte shkencore. Program i studimit i motivon studentët duke i përfshihen në punë të mirëfillta projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X

<p><b>Standardi II.7</b></p> <p><b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe</p>	<p>WBU i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim</p>

<p>projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>shkencor. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financave është i organizuar në grupe mësimore dhe kërkimore, që kanë në përbërje personel me profilin e duhur akademik. Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të mirfilltë për realizimin e eksperimenteve të kërkimit shkencor sic janë laboratorët mësimore apo aplikimit dhe fitimin e projekteve të financuar nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. WBU për realizimin e punëve kërkimore shkencore ka kryer aplikime dhe ka fituar projekte në kuadër të Erasmus +.</p> <p><b>Evidenca nr 2.21</b> Lista e projekteve të aplikuara;</p> <p><b>Evidenca nr 2.24</b> Organizimi I grupeve kërkimore brenda Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe Financave;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës si edhe njësiti bazë të tjera të WBU në cdo fillim viti hartojnë planin vjetor me focus në procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Pjesë e zbatimit të këtyre planeve janë si personeli akademik ashtu edhe studentët e programeve të ndryshme, dhe në vecanti të programit të studimit Msc në Menaxhim spitalor.</p> <p><b>Evidenca nr 2.13</b> Plani i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe Financës;</p> <p><b>Evidenca nr 2.14</b> Plani i punës kërkimore shkencore i FETI;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, konstatohet se Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financave, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Msc në Menaxhim spitalor, gjatë vitit 2022-2023 ka organizuar disa aktivitete shkencore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Western Balkans Innovation Summit, organizuar nga FETI, 8 Qershor 2023;</li> <li>2. Konferenca e parë ndërkombëtare në Sitemet e Bujqësisë së Qëndrueshme, 17-19 Maj 2023, Tetovë, bashkëorganizator;</li> </ol> <p>Këto konferenca ndihmojnë si personelin akademik ashtu edhe studentët për arritjen e objektivave mësimorë.</p> <p><b>Evidenca nr 2.32</b> Lista e aktiviteteve të organizuara nga FETI gjatë vitit akademik 2022-2023 me personelin akademik dhe studentët;</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi studimit MSc në Menaxhim Spitalor, bazuar në objektivat dhe misionin e tij synon rritjen e kapaciteve profesionale në fushën e menaxhimit shëndetësor, në nivele të ndryshme të tij, dhe element si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- menaxhimi burimeve njerëzore;</li> <li>- menaxhimi financiar;</li> <li>- menaxhimi i pacientit, me qëllim për tu përshtatur me tregun e punës brënda vëndit apo jashtë tij;</li> </ul> <p>Evidenca nr 2.2 Kurrikula e programit:</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Menaxhim spitalor është i ri dhe unik në vend, gjithsesi WBU ka marrë në konsideratë gjatë fazës së studimit të tregut edhe rekomandimet nga aktorë dhe faktorë në fushën e shëndetësisë, sidomos partnerëve të tij strategjik, si Grupi i Spitaleve Amerikane, Spitali Hygea.</p> <p>Evidenca nr 1.5 Studimi I tregut të punës për hapjen e programit master I shkencave në “Menaxhim spitalor”:</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Nuk aplikohet sepse nuk përfshihet në profesionet e rregulluara produkti i këtij programi.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vëren se WBU ka një harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të rëndësishme zë përfshirja e studentëve në kërkim shkencor. IAL ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të mirfilltë për detyra kursi sic janë laboratorët mësimore apo aplikimi dhe fitimin e projekteve të financuar nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. FETI për realizmin e punëve kërkimore shkencore ka marrëveshje bashkëpunimi me strukturat spitalore si Spitali Hygea, Grupi I Spitaleve Amerikane. Programi studimit ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për rritjen e kapaciteve profesionale në fushën e menaxhimit shëndetësor në cdo nivel, si dhe për tu përshtatur me tregun e</i></p>

	<i>punës brenda vëndit apo jashtë tij. Institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafit për thirjet e projekteve me fonde nga burime jashtë institucionit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ vëren se për realizimin e procesit mësimor personeli akademik i WBU përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Power Point, biseda interaktive me studentët apo temave të vecanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo praktikës mësimore.  Evidenca nr 3.1 Syllabusët e lëndëve: Takim me personelin akademik; Takim me studentët;
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi	Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Institucioni ka krijuar infrastrukturë laboratorike të





<p>alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>cilat ju shërbejnë studentëve për aftësimin e tyre praktik dhe profesinal.</p> <p>Takimime stafin akademik, Vizita në institucion:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>U konstatua se institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në program bashkëpunimi për shkëmbim eksperiencve midis IAL në kuadër të programeve Erasmus, konferenca shkencore, aktivitetet trainuese sipas shkallës së kualifikimit, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike.</p> <p>Takim me stafin akademik:</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc në Menaxhim spitalor ka përgatitje profesionale pedagogjike në lëndët që zhvillon. GVJ konstaton se formimi profesional përputhet me lëndën që zhvillon në këtë program studimi.</p> <p>I gjithë stafi akademik është me formim në universitetet jashtë vendit. Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin institucioni mundëson stafin akademik përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënie si projektorët, prezantime poëer point, metoda interaktive. Sic është theksuar edhe në standartet e mësipërme IAL ka investuar në krijimin infrastrukturën e nevojshme laboratorike për demonstrimin e praktikave mësimore.</p> <p>Takim me stafin akademik;</p> <p><b>Evidenca</b> extra CV e stafit për programin MSc në Menaxhim spitalor;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit të lëndës para cdo provimi, pyetësor për vlerësimin e programit, si dhe përfaqësim të tyre në struktura drejtuese si senati akademik.</p> <p>Takim me studentët;</p> <p>Takim me zyrën e NJSBC;</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të WBU/ Fakulteteve/ departamenteve të cilat janë në funksion të organizmit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka WBU. Njësitë kryesore që asistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë janë NJSBC dhe zyra e kurrikulave, zyra e kërkimit shkencor. NJSBC dhe zyra e kurrikulave është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuar nga departamentet, pjesëmarrja e lektorëve të jashtëm, trajnimet periodike të stafit akademik. Stafit akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin si me anë të projektorëve, prezantime pour point, paraqitjen e materialeve audiovizive, metoda interaktive, organizmin e leksioneve të hapura me pedagogë dhe expert të jashtëm.</p> <p>Evidenca nr 1.1 Statuti I WBU; Evidenca nr 1.2 Rregullorja themelore e WBU; Takim me zyrën e kërkimit shkencor; Takim me stafin akademik;</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>WBU dhe personeli akademik përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. IAL ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike të ndryshme në funksion të formimit profesional, teorik dhe praktik të studentëve.</i></p> <p><i>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperincë mjekësorë apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. NJSBC dhe kurrikulave është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Stafit akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie për realizimin e procesit mësimor si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumnetacionit të vënë në dispozicion dhe takimet e zhvilluar në institucion me studentët dhe pedagogë konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve dhe aftësive profesionale të stafit bazohen në rregulloret e institucionit miratuar nga Senati Akademik. Studentët njihen me këto rregullore gjatë tureve të orientimit të studentëve si dhe nga pedagogu i lëndës në fillim të sylabusit përkatës. Gjithë informacionin studentët e gjenë edhe në platformën SMART WBU.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.1 Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë;</p> <p>Takim me studentët e programit të studimit;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të lëndës pedagogu prezanton sylabusin e lëndës, mënyrën e realizimit të procesit mësimor, tematikën e leksioneve, seminareve dhe praktikave laboratorike dhe orët mësimore përkatëse sipas ECTS që ka lënda. Pedagogu informon studentit për mënyrën e frekuentimit të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, seminare) është detyrueshëm në masën 80% të orëve, frekuentimi laboratorëve mësimore dhe praktikës profesionale në masën 100%. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas rregullores së FETI dhe rregullores së programit mësimor. Gjithë informacioni ju vihet në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës dhe në cdo sylabus. Gjithë informacionin studentët e gjenë edhe në platformën SMART WBU.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.1 Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë:</p> <p>Takim me studentët e programit të studimit;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale kryhet në mënyrë të vazhdueshme sipas tipologjisë së lëndëve dhe bazohet në rregulloren e programit të studimit Msc në Menaxhim spitalor. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:</p>

<p>forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>a) me provim me shkrim; b) me gojë ose i kombinuar; c) me detyra kursi, projekte;</p> <p>Provimet me shkrim bëhen të sekretuara. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimit me 10 nota, nga 4-tra tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është 5 (pesë).</p> <p><b>Evidenca nr 2.1</b> Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë: Takim me personelin akademik;</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Frekuentimi i procesit mësimor dhe vlerësimi i dijeve të studentit bazohet në rregulloren e programit të studimit. Studenti njihet me frekuentimit e programit mësimor dhe vlerësimin e dijeve nga pedagogu i lëndës në fillim të sylabusit përkatës si dhe përmes aplikacionit SMART WBU. Në çdo sylabus paraqitet dhe mënyra e vlerësimit nga pedagogu.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.3</b> <b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulet.</p>	<p>Bazuar në DVV, sylabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj, sipas komponentëve të përcaktuar në sylabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës.</p> <p>Institucioni zotëron të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe ju vihet këtyre të fundit në dispozicion në nga pedagogu i lëndës dhe në çdo sylabus.</p>

	<p>Evidenca nr 2.1 Rregullorja e studimit cikli I dytë;</p> <p>Evidenca nr 3.1 Syllabuset e lëndëve;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). WBU ka të vendosur në zbatim sistemin SMART-WBU i cili gjeneron bar kode unike për cdo tezë provimi, e cila mundëson integritetin e provimit, si dhe korrigjimin pa e ditur studentin. Stafi akademik përdor edhe metoda të tjera vlerësimi të ndërmjetëm si Google form që shmangin abuzimin dhe rrisin transparencën.</p> <p>Evidenca nr 3.16 Udhëzim për procesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik;</p> <p>Takim me stafin akademik;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullores së FETI dhe rregullores së programit të studimit të ciklit të dytë. Vlerësimi i dijeve bëhet në provim të ndërmjetëm, provim përfundimtarë, riprovimi dhe provim i përmirësimit. Teza e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës dhe vlerësimi i dijeve bëhet me sistemin e notave ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 maksimale. I gjithë procesi i vlerësimit përfundimtar bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Evidenca nr 2.1 Rregullorja e programit të studimit cikli I dytë; Evidenca nr 3.1 Syllabuset e lëndëve;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret institucionale. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit.</p> <p>Bazuar në kuadrin rregullator të institucionit për provimet, pas cdo testimi studentët njihen me vlerësimin, bëjnë komente apo ankesë ndaj vlerësimit, si dhe marrin këshillat e duhura për procesin e të mësuarit të vazhdueshëm në të ardhmen dhe përmirësimin e tyre.</p> <p>Evidenca nr 2.1 Rregullorja e programit të studimit cikli I dytë</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli</p>	<p>GVJ vëren se institucioni ka investuar në sisteme për të siguruar integritetin, transparencën dhe cilësinë e provimeve.</p>

<p>akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Për këtë, një masë me rëndësi është shmangia e plagjiaturës, dhe për këtë IAL deklaron se në kuadër të projekti Erasmus + po investon për ngritjen e kapaciteteve CBHE “QA_SURE”për system elektronik antiplagjiature. Gjithashtu, në Kodi I Etikës së studentëve në ËBU është e ndaluar plagjiatura.</p> <p>Evidenca nr 3.19 Kodi I Etikës së studentëve në ËBU; Evidenca nr 2.1 Rregullorja për programet e ciklit të dytë; Evidenca nr 3.16 Udhëzim për procesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik;</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi i provimit dhe komunikimi i rezultateve bëhet sipas rregulloreve të programit të studimit të ciklit të dytë. Rezultatet pasqyrohen në procesverbalin e vlerësimit, në regjistrin e notave dhe regjistrin elektronik. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 2 javë nga mbarimi i sezonit.</p> <p>Evidenca nr 1.2 Rregullorja themelore e ËBU; Evidenca nr 2.1 Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë;</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit një javë pasi ka dalë rezultati, nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Studentët e programit MSc në Menaxhim spitalor shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve.</p> <p>Evidenca nr 1.2 Rregullorja themelore e ËBU; Evidenca nr 2.1 Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë;</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ vlerëson që një student i cili ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi, ai ka të drejtën e ankimimit, e cila vlerësohet nga një komision që ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit dhe përbëhet prej tre vetash, ku pedagogu i lëndës nuk bën pjesë. Vendimi i komisionit i bëhet i ditur studentit jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së ankesës.</p> <p>Evidenca nr 1.2 Rregullorja themelore e ËBU; Evidenca nr 2.1 Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë;</p>

<b>Konkluzione</b>	<i>Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik. Vlerësimi i dijeve bëhet në provim të ndërmjetëm, provim përfundimtarë, riprovimi dhe provim i përmirësimit. Rezultatet e provimit ju komunikohen studentëve në kohë duke respektuar afatet ligjore të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit. Studenti ka të drejtën e ankimit të rezultatit. Procedura e ankimit kryhet sipas rregullores themelore të EBU dhe të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i shkencave “Menaxhim spitalor” është me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe ka 120 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS = 25 orë punë studentit në auditor dhe ashtë auditorit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, apo praktika profesionale. Organizmi i programit mësimor si dhe kurikulat e programit/ syllabuset/ lëndët mësimorë mundësojnë formimin profesional të thelluar dhe zhvillim të aftësive të vecanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup.</p> <p>Evidenca nr 2.2 Kurrikula e programit Master I shkencave në “Menaxhim spitalor”;</p> <p>Evidenca nr 3.1 Syllabuset e lëndëve;</p> <p>Evidenca nr 2.1 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë:</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Pjesë të programit mësimor përvec lëndëve të formit profesional janë dhe ato të formit të përgjithshëm si informatika në kujdesin shëndetësor, statistika dhe përpunimi i të dhënave spitalore, inovacioni dhe sipërmarrja

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>shëndetësore, dhe em e rëndësishmja është që programi zhvillohet në gjuhën angleze.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit Master I shkencave në “Menaxhim spitalor”;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 3.1 Syllabuset e lëndëve:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Programi Master i shkencave në “Menaxhim spitalor” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin menaxher shëndetësor, dhe të formojë studentët me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike, në fusha të specializuar të menaxhimit shëndetësor.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve janë të përshkruara objektivat e lëndës, kompetencat dhe aftësitë që do të fitojë student në fund të saj. Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme orën e fundit të mësimit, pedagogu si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në vecanti në temat që kanë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentëve.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit Master I shkencave në “Menaxhim spitalor”;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 3.1 Syllabuset e lëndëve:</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me personalitete në fushën e menaxhimit shëndetësor. Një vënd të rëndësishëm në program zë praktika profesionale në spitalet që janë në bashkëpunim me WBU, ku studentët bashkojnë teorinë e marrë në auditor me skenarët realist, si dhe fitojnë aftësi dhe kompetencë për ushtrimin e profesionit të menaxherit shëndetësor. Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminare apo aktiviteteve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese komunikimit me etike midis kolegëve. Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie, në punimin e temave të diplomës. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentë në bashkëpunim me pedagogët.</p>



<p>mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Këtij qëllimi i shërbejnë angazhimi që WBU ju bën studentëve në projektet që IAL ka me programet Erasmus + apo projekte të tjera.</p> <p><b>Evidenca</b> nr 2.2 Kurrikula e programit Master I shkencave në “Menaxhim spitalor”;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 3.1 Sylabuset e lëndëve; Takimi me zyrën e kërkimit shkencor;</p> <p><b>Evidenca</b> 2.32 Lista e aktiviteteve të organizuara nga FETI gjatë vitit akademik 2022-2023 me personelin akademik dhe studentët;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë në WBU realizon orë të hapura, seminare dhe webinare për tu njohur me të rejat e shkencës dhe teknologjisë në lidhje me menaxhimin shëndetësor. IAL ka ftuar personalitet të fushë së menaxhimit shëndetësor, shëndetit public apo të punësuar në institucione të kujdesit shëndetësor.</p> <p><b>Evidenca</b> 2.32 Lista e aktiviteteve të organizuara nga FETI gjatë vitit akademik 2022-2023 me personelin akademik dhe studentët;</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në terren ka vërejtur që WBU si një institucion i ri ka qendër të vëmendjes kërkimin shkencor. Në këtë drejtim kanë vëmendjen e tyre dhe studentët, të cilët janë të përfshirë në projekte të IAL.</p> <p>Takim me studentët; Takim me Zyrën e Kërkimit Shkencor;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 3.21 Lista e studentëve pjesë e mobilitetit;</p> <p><b>Evidenca</b> nr 3.22 Vizitë studimore e studentëve të ËBU në Universitetin e Saxon në Holandë;</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Organizmi i programit mësimor si dhe kurikulat e programit/sylabuset/ lëndët mësimorë mundësojnë formimin të thelluar profesional dhe zhvillim të aftësive të vecanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup në fushën e menaxhimit shëndetësor. Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, ëbinare jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e menaxhimit shëndetësor apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre. Programi Master i Shkencave në “Menaxhim spitalor” ka patur shkëmbime eksperiencia me studentë dhe pedagogë në</i></p>

	<i>kuadër të Erasmus+. Institucioni mbështet studentët për kërkimin shkencor duke i bërë pjesë të projekteve që ka IAL.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplome Master shkencor në “Menaxhim spitalor,” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren themelore të WBU, statutin e WBU, si dhe në rregulloren e programit të studimit Msc në Menaxhim Spitalor. Këto rregulla ju bëhen me dije studentit në fillim të vitit akademik si dhe janë publike në ëeb faqen e Universitetit Western Balkans.</p> <p>Evidenca nr 2.1 Rregullorja e studimit e programit të nivelit të dytë:</p> <p>Evidenca nr 1.1 Statuti I ËBU;</p> <p>Evidenca nr 1.2 Rregullorja themelore e ËBU; <a href="https://ëbu.edu.al/en/program/msc-in-hospital-management">https://ëbu.edu.al/en/program/msc-in-hospital-management</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Koordinatori i programit, këshilltari akademik, Përgjegjësi i Departamentit dhe udhëheqësit e temave të diplomave asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse – provimit përmbyllës përmes diplomës.</p> <p>Evidenca nr 1.2 Rregullorja themelore e ËBU:</p>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike përmes tezës së mbrojtjes së diplomës. Institucioni ka të përcaktuara me detaje strukturën e tezës dhe formatin e saj, me qëllim udhëzimin e studentit për puniun e tezës.</p>

<p>të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Evidenca nr. 2.3 Manuali për puniminë tezës:</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga biseda me studentët e programit të studimit dhe të personelit akademik që japin mësim dhe janë udhëheqës teze, vërehet se udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><b>Takimi me studentët;</b></p> <p><b>Takimi me personelin akademik:</b></p> <p><b>Evidenca 2.1</b> Rregullore e programit të ciklit të dytë;</p> <p><b>Evidenca nr 2.3</b> Manuali për punimin e tezës;</p> <p><b>Evidenca nr 3.1</b> Sylabuset që zhvillohen në programin e studimit Msc në Menaxhim spitalor;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>WBU ka krijuar infrastrukturën e duhur laboratorike brenda institucionit, si edhe infrastrukturën në institucionet partnere, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Grupi i Sitaleve Amerikane;</li> <li>- International Hygea Hospital Sh.A;</li> <li>- Cambridge Clinical Laboratories;</li> </ul> <p>me të cilët WBU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><b>Evidenca 1.12</b> Marrëveshje bashkëpunimi me CCL;</p> <p><b>Evidenca nr 1.14</b> Lista e marrëveshjeve EPIC;</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Studentët e programi të studimit Msc Menaxhim spitalor në përfundim të studimeve kryejnë mbrojtjen e diplomës dhe bazuar në sylabusin e lëndëve vlerësohet me notë njësoj si lëndët e tjera të programit. Tema e diplomës vlerësohet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) si dhe sistemit amerikan që aplikohet në WBU.</p> <p><b>Evidenca nr 3.1</b> Sylabuset që zhvillohen në programin e studimit Msc në Menaxhim spitalor;</p>

	Evidencë nr 3.24 Sylabus I lëndës “Punim diplome për MSc Menaxhim Spitalor”:			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Cdo student hyn në mbrojtje e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike. Pasi ka shlyer detyrimet dhe mbrojtjen e diplomes, student pajiset me diplomën përkatëse si dokument zyrtar, i cili nënshkruhet nga Rektori dhe Dekani i fakultetit. Tërheqja e diplomës he suplementit tërhiqet nga vetë student i cili nënshkruan në regjistrin përkatës.  Evidencë nr 3.25 Model diplome: Evidencë nr 1.2 Rregullorja themelore e Universitetit Western Balkans;			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në Sekretarinë Mësimore vërejmë që institucioni ruan kopje fizike dhe elektronike të të dhënave të studentit. Dokumentacioni ruhet sipas dispozitave ligjore dhe rregulloreve të brendshme. Sekretaria ka dhe mban regjistrin me të dhënat e numrit të studentëve dhe numrin e matrikullimit. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave për studentët, që i shënon në regjistrin bazë të të dhënave personale të studentëve të regjistruar, transferuar apo diplomuar. Procesi i ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave për studentët bazohet në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucioni përdor platformën SMART WBU që kryen digitalizimin e dokumentacionit sipas njësisive bazë.  Evidenca nr 1.1 Statuti I Univesritetit Western Balkanas; Evidenca nr 3.26 Rregullorja për mbrojtjen , përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personel; Evidenca nr 3.27 Rregullore e zyrës së Sekretarisë Mësimore;			
<b>Konkluzione</b>	<i>WBU ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit. WBU pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>				
<b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
<b>Konkluzione</b>	N / A			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i institucionit e mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit, duke përmbushur kërkesat e kornizës ligjore në fuqi. Personeli është i kualifikuar, ka përvojë të mjaftueshme në fushat përkatëse dhe ka një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore. Institucioni zbaton mekanizma të qartë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë. Staf i akademik për programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Spitalor" sipas titujve dhe gradave për dy vite akademike paraqitet si vijon:					
	Kualifikimi i stafit akademik të PS		2022 - 2023		2023 - 2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK	
	Prof. Dr	-	-	-	-	
	Prof. Asoc.	1	-	1	-	
	Dr/Phd	5	1	6	2	
	SPA	-	-	-	1	
	Msc.	2	-	2	2	
<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>5</b>		
Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa me sipër konstatohet se:						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- në vitin akademik 2022-2023, 2 / 9 (22.2 %) staf mësimdhënës janë me Msc;</li> <li>- në vitin akademik 2023-2024, 4 / 14 (28.5 %) staf mësimdhënës janë me Msc;</li> </ul>						

	<p>Pavarësisht numrit të vogël të stafit mësimdhënës me Msc, <u>GVJ i sugjeron insitucionit të marrë masa për të rritur cilësinë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi me gradën Dr, sipas akteve ligjore në fuqi.</u></p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik, GVJ konstatoi se:</p> <p><u>bartësi i lëndës “Menaxhimi i pacientit dhe kujdesi spitalor” nuk i përket fushës së mjekësisë.</u> Prania e mjekut si ligjërues në këtë lëndë mund të ketë disa përparësi. Fillimisht, mjeku sjell me vete përvojën nga vija e parë e kontaktit me pacientin dhe vendimmarrjen për trajtimin e tij mjekësor. Këto komponenta janë të rëndësishme në integrimin e menaxhimit shëndetësor me shëndetin publik. Mjeku është trajnuar për të qenë pjesë aktive e ekipit mjekësor multidiciplinar, përmes të cilit ai e kupton tërësinë e problemeve të ndryshme shëndetësore. Këto probleme mund ta prekin menaxhimin e institucionit shëndetësor nga shumë kënde, siç janë sëmundjet ngjitëse, sëmundjet kronike dhe kujdesi emergjent shëndetësor. Prandaj, roli i mjekut është i pazëvendësueshëm në punën ekipore, vendimarrje, parime etike, politika shëndetësore dhe menaxhim të krizave shëndetsore. Përparësi tjetër është edhe përvoja e mjekut në fushën e kërkimeve shkencore dhe praktikat mjekësore që bazohen në dëshmi shkencore. Këto veçori i ndihmojnë pedagogut për t’i përgatitur më mirë studentët e menaxhmentit në rolin e tyre si liderë të ardhshëm institucional.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU:</p> <p>Evidenca 1.3 Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjise dhe Inovacionit:</p> <p>Evidenca 1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital sh.a dhe Shoqërinë International Hospital sh.a:</p> <p>Evidenca 1.10 Rregullorja mbi Organizimin Akademik;</p> <p>Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve të ciklit të dytë;</p> <p>Evidenca 2.5 Lista e Personelit;</p> <p>Evidenca Nr.4.1 Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë:</p>
<p><b>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e</b></p>	<p>WBU përcakton ngarkesën mësimore për personelin akademik në përputhje me kornizën aktuale ligjore. Mësimdhënësit në programin Master në “Menaxhim spitalor” posedojnë gradën doktor shkence ose janë profesorë, por ka edhe me gradën MSc në kundërshtim me ligjin. Pjesa më e</p>

<p>studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>madhe e mësimit mbulohet nga personeli me orar të plotë, kurse pjesa tjetër nga personeli me kontratë. Ngarkesa për personelin akademik në WBU përcaktohet nga marrëveshjet e punësimit dhe rregulloret në fuqi. Ngarkesa minimale për personelin është 8 orë në javë, kurse për atë me kohë të pjesshme është 120 orë mësimore vjetore për të gjitha kategoritë. Përballimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik, në 2 vitet e fundit, paraqitet si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="624 613 1334 763"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>PAE (%)</th> <th>PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022 - 2023</td> <td>90 %</td> <td>10 %</td> </tr> <tr> <td>2023 - 2024</td> <td>87 %</td> <td>13 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidenca 2.28 Udhëzim për ngarkesën mësimore në WBU; Evidenca Nr.4.2 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Aneks. Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 6.1-6.3 dhe 12.1-12.2); Evidenca Nr.4.3 Ngarkesa mesimore;</p>	Viti akademik	PAE (%)	PAK (%)	2022 - 2023	90 %	10 %	2023 - 2024	87 %	13 %
Viti akademik	PAE (%)	PAK (%)								
2022 - 2023	90 %	10 %								
2023 - 2024	87 %	13 %								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>WBU siguron përputhje në sferën e kualifikimeve, moshës dhe përvojës së personelit akademik. Kontratat e punës dhe çështjet juridike të punës zgjidhen nga Statuti i institucionit, Kodi i Punës dhe ligjet e arsimit të lartë. Të gjitha kontratat janë të regjistruara nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Institucioni ofron edhe sigurime shëndetësore. Në bashkëpunim me Spitalin Amerikan, institucioni ofron mbështetje ekonomike dhe sociale, duke garantuar 30-70% ulje të koston së shërbimeve të ofruara mjekësore për stafin akademik dhe familjet e tyre.</p> <p>Evidenca Nr.4.4 Oferta akademike e WBU 2023-2024; Evidenca Nr.4.5-Lista e stafit akademik sipas njësive bazë; Evidenca Nr.4.6 Kontrata e punës së personelit akademik; Evidenca Nr.4.7 Lista e stafit të angazhuar në programin e studimit;</p>									
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e</p>	<p>Kriteret e rekrutimit të personelit akademik përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori. Bazë për rekrutim është Kodi i Punës. Njoftimi për vendin e lirë të punës shpallet në faqen zyrtare të institucionit dhe në kanale të tjera të komunikimit. Dekani përzgjidh një komision ad-hoc që udhëheq konkursin. Pas përmbylljes së procedurave të vlerësimit, komisioni i rekomandon Rektoratit përzgjedhjen e</p>									



<p>duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>kandidatit që plotëson më së miri kushtet e konkursit. Në fund, personi i përzgjedhur pajiset me kontratë pune. Për nevojat e veta, WBU punëson edhe staf akademik dhe administrativ me orar të pjesshëm, si dhe kontraktin ekspertë të jashtëm sipas fushave përkatëse të ekspertizës. Kontrata rinovohet bazuar në vlerësimet e performancës në fushat e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe mbështetjes në avancimin e institucionit.</p> <p>Evidenca Nr.4.11 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit,;</p> <p>Evidenca Nr.4.12-Linku për publikimin e vendeve të lira të punës;</p> <p>Evidenca Nr.4.13 Praktika e punësimit në WBU;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>WBU ka angazhuar personel ndihmës akademik të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore. WBU ka siguruar që ky program studimi të ketë mbështetjen e duhur për të arritur standardet akademike dhe për të siguruar një përvojë mësimore cilësore për studentët.</p> <p>Evidenca 1.10-Rregullorja mbi Organizimin Akademik</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Personeli për këtë program zgjidhet në fillim të vitit akademik, bazuar në kriteret e paracaktuara nga kuadri ligjor dhe rregulloret e brendshme. WBU ka në strukturën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ. Baza e të dhënave e disponuar përditësohet vazhdimisht në përputhje me numrin total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program dhe mbulimit të ngarkesës së programit. GVJ u informua se të dhënat menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo zyrë menaxhon rekrutimin, obligimet, ndryshimet e detyrave të punës dhe politikat e punësimit të stafit, si dhe mban të dhëna të detajuara për gjithë personelin, përfshirë stafin akademik, koordinatorët e programeve, stafin mbështetës dhe administrativ. Njëkohësisht, zyra përditëson dosjet e</p>

	<p>personelit, mban kontratat e punës dhe mbikëqyr përfundimin e tyre.</p> <p>Evidenca 2.5 Lista e Personelit;</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>WBU ka bashkëpunim me partnerë vendor e ndërkombëtarë, të cilët ju ndihmojnë studentëve në realizimin e praktikave profesionale dhe kërkimeve shkencore për realizimin e temave të diplomës. Praktikave profesionale dhe punimet e diplomës mbikëqyren nga drejtuesit e departamenteve, koordinatorët dhe mbikëqyrësit e temave. Mbikëqyrësit mund të jenë personel institucional ose të punësuar në kompanitë partnere. Temat e diplomave dhe anëtarët e komisionit për mbrojtjen e tyre propozohen nga njësi bazë, me miratimin e Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe Financës dhe Zyrës së Dekanit.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 1.7 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU;</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktikat profesionale zhvillohen në institucione publike, në kompani private dhe në profesionet e lira të caktuara nga shkolla, sipas marrëveshjeve bilaterale. WBU ka bashkëpunim me disa partnerë (American Hospital, International Hygea Hospital, Cambridge Clinical Laboratories, etj.), ku studentët i kryjnë praktikave profesionale. Zhvillimi i praktikave të tyre profesionale mbikëqyret nga personeli përgjegjës dhe në përfundim të praktikës mbahet një dokumentacion vlerësues. Praktikave profesionale kryhen në grupe të vogla, deri në 20 studentë dhe vlerësohen me nota, njëllor sikur detyrimet e tjera të studentëve. Studentët janë të obliguar t'i ndjekin këto praktika profesionale.</p> <p>Evidenca 1.12 Marrëveshje Bashkëpunimi me CCL;</p> <p>Evidenca 1.8 Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital sh.a dhe Shoqërinë International Hospital sh.al;</p> <p>Evidenca 1.9 Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;</p>

<b>Konkluzione</b>	<p>Stafi akademik në WBU përgjithësisht i plotëson kërkesat ligjore për ngarkesat mësimore, me personel të kualifikuar, (me përjashtim të një numri të vogël) dhe me përvojë.</p> <p><u>GVJ i sugjeron insitucionit të marrë masa për të mbuluar të gjithë mësimdhënien e programit të studimit me personel akademik me së paku me gradën "Dr", sipas akteve ligjore në fuqi.</u></p> <p><u>GVJ sugjeron që një profesionist mjekësor të jetë bartës i lëndës "Menaxhimi i Pacientit dhe Kujdesi Spitalor". WBU punëson personel me orar të plotë dhe të pjesshëm. Kontratat e punës menaxhohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila gjithashtu ofron sigurime shëndetësore dhe mbështetje ekonomike përmes partnerëve. Rekrutimi ndjek bazën ligjore. WBU bashkëpunon me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë për praktika profesionale dhe projekte kërkimore.</u></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>WBU ka siguruar mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, natyrës specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p>WBU posedon kampusin universitar me 3 godina, ambient parkimi dhe oborr. Godinat përmbajnë hapësira të mjaftueshme infrastrukturore për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parapara për realizimin e programit master në menaxhim shëndetësor (salla për leksione, seminare e konferenca; ambiente për laborator; salla për internet dhe aktivitete promovuese; sallë biblioteke me dhoma studimi; mjedise administrative, mjedise për aktivitete sportive, aktivitete të qeverisë studentore, kafeteri fast-food, zyra për personelin akademik dhe administrative dhe salla mbledhjesh). Kjo infrastrukturë është pasuri e paluajtshme e WBU-së sipas kontratës së qirasë për një periudhë të vlefshme</p>



	<p>deri 2032. Institucioni siguron mbështetje financiare të nevojshme për menaxhimin, mirëmbajten dhe zhvillimin e aseteve të tij. Mjediset e institucionit i plotësojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe të gjitha standardet higjieniko-sanitare për studentët dhe personelin.</p> <p>Evidenca Nr.4.16 Fragmenti i Hartës Kadastrale të WBU-së; Evidenca Nr.4.17 Planimetria e Kampusit Universitar; Evidenca Nr.4.18 Kontrata e qerasë së godinave dhe certifikata e pronësisë; Evidenca Nr.4.19 Kontratë Sipërmarrje Punimesh;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e WBU konstatoi se disponohen klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, të cilat janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Laboratorët janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimor. Zyrat e personelit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme të punës, duke përfshirë pajisjet teknologjike dhe elektronike. Këto mjedise kanë tabela inteligjente (SMART BOARDS) që përdoren gjatë procesit mësimor.</p> <p>Evidenca Nr.4.20 Model inventari i zyrës së personelit akademik; Evidenca Nr.4.21 Plan shpërndarja e Smart-Boards;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Spitalor" realizimi i seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. Në WBU funksionojnë 27 laboratorë, studio e mjedise të tjera mësimore. Ato janë të pajisur me aparatura, pajisje dhe mjete bashkëkohore të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve. Ambientet laboratorike janë të pajisura me mjetet e nevojshme për procesin mësimor dhe me manualet e laboratorit, sipas specifikave të tyre. Mbetjet laboratorike trajtohen sipas marrëveshjes së evadimit.</p> <p>Evidenca Nr.4.22 Lista e Laboratoreve; Evidenca Nr.4.23 Inventar Laboratori; Evidenca Nr.4.24 Manualet e Laboratoreve;</p>

	Evidenca Nr.4.25 Marrëveshja për evadimin e mbetjeve laboratorike:
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni posedon tre laboratorë të teknologjisë së informacionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Laboratori i Shkencave Kompjuterike të Inteligjencës Artificiale;</li> <li>- Laboratori i Shkencave Kompjuterike të Sigurisë Kibernetike;</li> <li>- Laboratori i Shkencave Kompjuterike të Inxhinierisë Software;</li> </ul> <p>Përmes SMART WBU realizohet informatizimi i dokumentacionit, si dhe të procesve dhe procedurave në funksion të veprimtarive institucionale. Studentët kanë në dispozicion bibliotekën dhe një databazë digjitale dhe laboratorin e VR (Virtual Reality), i cili ndihmon studentët të realizojnë seanca të posaçme mësimore.</p> <p>Evidenca Nr.3.15-Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU:</p> <p>Evidenca Nr.4.22 Lista e Laboratoreve;</p> <p>Evidenca Nr.4.26 Kontrata për shërbimin e internetit:</p> <p>Evidenca Nr.4.27-Lista e aseteve teknologjike;</p> <p>Evidenca Nr.4.28 Dokumenti i abonimit në JSTOR;</p> <p>Evidenca Nr.4.29-Aksesi në Research for Life.pdf;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore,</p>	<p>WBU ka një rrjet partnerësh që garantojnë përmbushjen e nevojave të realizimit me sukses të programeve të studimit, përfshirë komponentët praktike të studimeve.</p> <p>Institucioni ka siguruar kapacitete të mjaftueshme të strukturave spitalore dhe ambulatore për realizimin e programit të menaxhimit spitalor.</p> <p>Evidenca 1.7 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU</p>

institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	
<b>Konkluzione</b>	<i>WBU siguron mjedis të përshtatshëm për veprimtarinë mësimore, përfshirë një kampus me tre godina dhe ambiente të ndryshme për leksione, laboratorë, biblioteka dhe zyra për stafin. Institucioni plotëson standardet higjienike dhe mbështet financiarisht menaxhimin e aseteve. Mjediset mësimore dhe laboratorët janë të pajisur me teknologji moderne. WBU bashkëpunon me partnerë për praktika profesionale dhe projekte kërkimore, duke përdorur teknologjinë SMART WBU për informatizimin e dokumentacionit.</i>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
	<b>Përmbushet kryesisht</b>
	<b>Përmbushet plotësisht</b>
	<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Gjuha në të cilën zhvillohet procesi mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Spitalor" është gjuha angleze. Nga takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e përditësuar, e përshtatshme dhe e përdorur në nivel ndërkombëtar në programe të ngjashme. Literatura disponohet si në formë fizike ashtu edhe digjitale, falë anëtarësimeve në JSTOR dhe Research4Life. Aktualisht, burimet fizike janë mbi 30,000 me 6,300 të regjistruara deri tani, dhe mbi 250,000 tituj librash elektronike. Biblioteka mundëson edhe 36 burime online, të qasshme në <a href="https://library.WBU.edu.al/">https://library.WBU.edu.al/</a>.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve u konstatua se literature e ofruar i përket kryesisht botimeve të pesë viteve të fundit nga shtëpi botuese prestigjioze ndërkombëtare si Springer, Taylor and Francis, Willis, etj. Biblioteka WBU <a href="https://library.WBU.edu.al/">https://library.WBU.edu.al/</a> është një aset i rëndësishëm për</p>



	<p>mbështetjen e procesit mësimor dhe për sigurimin e dijeve dhe njohurive të nevojshme sipas programit të studimit.</p> <p>Evidenca Nr.4.30 Lista e librave (Fondi i Bibliotekës);</p> <p>Evidenca Nr.4.31 Lista e lëndëve të kurrikulës mësimore të programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor”;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Biblioteka e WBU (<a href="https://library.WBU.edu.al/">https://library.WBU.edu.al/</a>) përditëson rregullisht koleksionin e saj me botime të reja dhe menaxhon regjistrimin e titujve të rinj për studentët, stafin dhe përdoruesit e tjerë. Zyra e menaxhimit të bibliotekës mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe mban të gjitha regjistrimet përkatëse. Koleksioni i bibliotekës zgjerohet vazhdimisht bazuar në kërkesat specifike të njësive akademike dhe nevojat direkte të studentëve. Personeli akademik rishikon dhe përditëson literaturën përkatëse çdo vit, duke reflektuar këto ndryshime në syllabuset e tyre të kurseve. Biblioteka rritet përmes blerjeve, donacioneve dhe abonimeve online.</p> <p>Evidenca Nr.4.28 Dokumenti i abonimit në JSTOR;</p> <p>Evidenca Nr.4.29-Aksesi në Research for Life;</p> <p>Evidenca Nr.4.30 Lista e librave (Fondi i Bibliotekës);</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e WBU ka një koleksion të gjerë burimesh fizike dhe digjitale, duke përfshirë libra, atlase, manuale, fletore pune, fjalorë, enciklopedi, revista, gazeta dhe materiale audiovizuale. Ajo ofron gjithashtu versione digjitale të literaturës (<a href="https://library.WBU.edu.al/">https://library.WBU.edu.al</a>). Burimet janë në përputhje me kurrikulën e universitetit dhe janë të disponueshme për fakultetin, stafin dhe studentët, të cilët duhet të respektojnë Rregulloren e Bibliotekës. Biblioteka ofron shërbime huazimi për materiale fizike dhe qasje online në burime digjitale përmes rrjetit WBUL. Qasja në distancë jashtë universitetit sigurohet përmes autentifikimit, duke garantuar përdorimin për qëllime personale, akademike dhe kërkimore në përputhje me ligjet e të drejtave të autorit.</p> <p>Evidenca Nr.4.32 Rregullorja e Bibliotekës;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka WBU është e pajisur me fond fizik të pasur që mbulon literaturën bazë të programit të studimit. Kjo lehtësohet dhe nga fakti që mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze. Në total biblioteka ka një numër</p>


<p>shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>materialesh të kataloguara në shkencë mjekësore në 8800 tituj, nga të cilët 2800 revista.</p> <p>Evidenca Nr.4.30 Lista e librave:  <a href="https://library.WBU.edu.al/sq/resources">https://library.WBU.edu.al/sq/resources</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik dhe administrativ, studentët nga të gjitha programet kanë qasje të lirë në burimet e bibliotekës. Resurset e bibliotekës menaxhohen sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloret e Bibliotekës (<a href="https://library.WBU.edu.al/en/rules">https://library.WBU.edu.al/en/rules</a>). Burimet elektronike janë të qasshme në kampus përmes rrjetit WBU ose përmes autentifikimit me email, me qasje nga largësia, varësisht nga licenca. Këto burime përdoren për qëllime personale, arsimore dhe shkencore duke ndjekur ligjin për të drejtat e autorit. Shërbimet e bibliotekës janë të planifikuara dhe të disponueshme për studentët.</p> <p>Evidenca Nr.4.32 Rregullorja e Bibliotekës:</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e WBU është e pajisur me kompjuterë, softuer dhe mjete të ndryshme teknike, duke siguruar qasje të pakufizuar në koleksione dhe burime informacioni për punën akademike dhe shkencore. Qasja në burimet elektronike të bibliotekës është e disponueshme në të gjitha kompjuterët e lidhur me rrjetin e WBU-së ose përmes autentifikimit me email. Gjithashtu, është ofruar qasje jashtë rrjetit të WBU-së, duke lejuar përdoruesit të kenë qasje të plotë nga çdo lokacion.</p> <p>Evidenca Nr.4.34 Rregullat e Bibliotekës në WBU:</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka u shërben studentëve gjatë orëve që përshtaten me orarin akademik për të përmbushur kërkesat e përdoruesve, me një kapacitet prej mbi 100 vendesh dhe 260 anëtarë. Ajo është e hapur nga ora 08:30 deri në 16:30. Koleksioni digjital është i qasshëm në çdo kohë përmes faqes së internetit të WBU-së dhe përmes platformës "SMART-WBU" për studentët dhe stafin. Biblioteka ofron huazimin e materialeve fizike, qasje falas në burimet online dhe rezervimin e dhomave të studimit.</p> <p>Evidenca Nr.4.34 Rregullat e Bibliotekës në WBU</p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka e WBU-së vazhdimisht përditëson fondin e saj dhe njofton stafin akademik dhe departamentet për shtesat e reja në burimet e saj fizike dhe online. Ajo bashkëpunon me programet akademike për të monitoruar dhe raportuar mbi përdorimin dhe cilësinë e koleksioneve të saj, duke detajuar blerjen e titujve të rinj, statistikën e përdorimit dhe efektivitetin e përmirësimeve të burimeve. Biblioteka gjithashtu identifikon nevojat për tituj të rinj dhe vlerëson performancën e stafit akademik bazuar në përdorimin e burimeve. Biblioteka bashkëpunon ngushtë me departamentet për të siguruar që titujt thelbësorë të jenë të disponueshëm për programet akademike.</p> <p>Evidenca Nr.4.35 Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës:</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Njësitë bazë të WBU përditësojnë literaturën në fillim të vitit akademik, me burime të disponueshme në formë fizike dhe digjitale. Biblioteka e WBU ofron mbi 30,000 burime fizike dhe 250,000 tituj librash elektronikë. Institucioni menaxhon 27 laboratorë dhe studio dhe bashkëpunon me partnerë për praktika profesionale dhe projekte kërkimore. Evidencat përfshijnë lista të librave, rregulloret e bibliotekës, dhe abonimet në burime digjitale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të</p>	<p>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim mbahet nga njësitë</p>

<p>menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>administrative, si zyrat e Sekretarisë Mësimore dhe Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. WBU ka në përdorim platformën SMART WBU, ku ka digjitalizuar dokumentacionin sipas njësive përkatëse.</p> <p>Zyra e Sekretarisë mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti që lidhet me studentët. Kjo zyre ofron një bazë të dhënash që përfshin të gjitha të dhënat lidhura me procesin e studimit, siç janë numri i studentëve që ndjekin programin, atyre që përfundojnë programin master dhe statistikave suplementare për nevojat e brendshme të menaxhimit. Të dhënat e studentëve ruhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me Statutin e WBU dhe me rregulloret mbi të dhënat, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</p> <p>Evidenca 2.11. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Western Balkans;</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</p> <p>Evidenca 2.11. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;</p> <p>Evidenca 3.27. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Për sa i përket menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ të angazhuar në realizimin e programit, në zyrën e Burimeve Njerëzore, ky informacion është i organizuar sipas dosjeve të posaçme të stafit, në mënyrë fizike, por edhe elektronike. Kjo zyrë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në çdo program studimi.</p> <p>Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se aksesin në sistemin e WBU mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Nëpërmjet këtij sistemi:</p>



<p>studentët e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët kanë akses në të dhënat e tyre akademike, notat, mungesat si dhe të dhënat financiare;</li> <li>- Staf i akademik ka akses për të parë rezultatet akademike të studentëve me qëllim që të ndjekë ecurinë e tyre dhe për të bërë këshillimin e duhur në lidhje me lëndët që studenti duhet të ndjekë në semestrin pasardhës;</li> </ul> <p><a href="https://WBU.edu.al/en/program/master-of-science-in-hospital-management">https://WBU.edu.al/en/program/master-of-science-in-hospital-management</a>;</p> <p>Evidenca 2.26 Lista e Grupeve të Punës për Shkrimin e projekteve;</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB sistemi i menaxhimit të WBU ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Studentët mund të qasen në syllabuset e lëndëve, vlerësimin e vazhduar, prezencën gjatë orëve mësimore, komunikimin me këshilltarin akademik dhe në çështje të tjera. Personeli i WBU-së dhe studentët janë të pajisur me adresa zyrtare të komunikimit të brendshëm elektronik nëpërmjet platformës "SMART-WBU" <a href="https://WBU.easy-web.cloud/">https://WBU.easy-web.cloud/</a>, <a href="https://smart.WBU.edu.al/">https://smart.WBU.edu.al/</a> për komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor. WBU publikon në mënyrë të vazhdueshme udhëzues për studentët gjatë tërë kohës së studimeve. Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, organizon javën e orientimit për studentët e rinj.</p> <p>Evidenca Nr.4.37 Ditët e informimit brenda institucionit për studentët organizimi i aktiviteteve informuese;</p> <p>Evidenca Nr.4.38 Guida e studentit;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në</p>	<p>Sistemi i menaxhimit WBU mundëson monitorimin e aktivitetit akademik administrativ të institucionit. Sistemi mundëson nxjerrjen e listave të notave të studentëve, listat e notave në bazë lënde, listë-prezencat për lëndët respektive, etj.</p> <p>Raportimet individuale të personelit akademik dhe administrativ bëhen në mënyrë periodike pranë departamenteve përkatëse dhe organeve dhe autoriteteve të</p>

kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	universitetit. Ky aktivitet mundësohet nga platforma "SMART-WBU"			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të dhënat për programin Master i Shkencave në "Menaxhim Spitalor" publikohen në faqen zyrtare të WBU. Në këtë faqe gjendet informacion i përditësuar edhe për personelin akademik, zyrat e shërbimeve studentore, kërkimin shkencor dhe projektet, aktivitete të ndryshme të organizuara në WBU, dokumentacionin e funksionimit të institucionit, vendimet e brendshme etj. Informacioni në faqen e internetit, ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze.  <a href="https://WBU.edu.al/sq/program/master-of-science-in-hospital-management">https://WBU.edu.al/sq/program/master-of-science-in-hospital-management</a> <a href="https://WBU.edu.al/en/program/master-of-science-in-hospital-management">https://WBU.edu.al/en/program/master-of-science-in-hospital-management</a>			
<b>Konkluzione</b>	<i>WBU ka digjitalizuar dokumentacionin përmes platformës SMART WBU, duke përfshirë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave nga zyrat administrative. Këto zyra menaxhojnë të dhënat e studentëve dhe personelit nga regjistrimi deri në përfundimin e studimeve, në përputhje me rregulloret dhe ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat e studentëve ruhen në një bazë të dhënash të sigurt dhe janë të aksesueshme për menaxhimin e brendshëm. Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe administrativ çdo vit akademik. Platforma SMART-WBU ofron komunikim interaktiv dhe qasje në informacione të ndryshme për studentët dhe personelin.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e	GVJ u informua se veprimtaria vjetore akademike dhe financiare e institucionit përmbledhet në raportin vjetor. Ky dokument diskutohet dhe miratohet në mbledhjet e Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Më tej,

<p>studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>dokumenti i dërgohet MAS-së si dhe publikohet në faqen zyrtare të WBU. Institucioni i përmbahet akteve ligjore në fuqi lidhur me raportimin financiar. Raportet financiare përgatiten çdo vit dhe përmbledhin të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të granteve të lidhura përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura me funksionin e institucionit. Të ardhurat vetanake përdoren tërësisht prej vetë institucionit. Pasqyrat financiare publikohen edhe në web faqen e QKR.</p> <p>Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve te ciklit te dyte:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra</p>	<p>Referuar RVB, buxheti i WBU-së është një dokument i detajuar, i cili përgatitet konform projekteve, realizimit të prithshëm të buxhetit, përditësimeve organizative, numrit të punonjësve, programeve të studimit dhe regjistrimit të studentëve. Njësitë përbërëse të WBU dorëzojnë kërkesat financiare përmes formularit "Kërkesa për Furnizim/Pajisje me Materiale" në Zyrën e Prokurimit dhe Shërbimeve Administrative, e cila siguron përputhshmërinë me kufijtë e buxhetit. Plani i financimit të WBU-së përfshin financimin për burimet njerëzore, mirëmbajtjen e objektit dhe teknologjisë, shpenzimet e bibliotekës, detyrimet financiare, grantet dhe kontratat e shërbimeve. Bordi i Administrimit menaxhon përgjegjësitë administrative, financiare, ekonomike dhe të pasurisë së institucionit, bazuar në Statutin dhe rregulloret e WBU-së. Si institucion privat, WBU nuk varet nga dispozitat ligjore që obligojnë zbatimin e sistemit të prokurimit përmes tenderëve. WBU përcakton nivelet e pagesave për punën plotësuese brenda institucionit.</p> <p>Evidenca 2.4 Buxheti i WBU 2023</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Referuar RVB-së konstatohet se institucioni kryen në mënyrë periodike auditime, për të vlerësuar dhe dokumentuar efektivitetin e financimit dhe të burimeve financiare. Përveç kësaj, institucioni i nënshtrohet edhe auditimeve të jashtme në përputhje me legjislacionin aktual.</p> <p>Evidenca Nr.4.39 Rregullorja e Zyrës së Prokurimeve dhe Sherbimeve Administrative</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Raportimi mbi buxhetin bëhet në nivel Fakulteti, ku njësia kryesore ka përfaqësuesit e saj. Sipas Rregullores për organizimin administrativ të WBU, administratori i fakultetit është përgjegjës për operacionet financiare dhe administrative të fakultetit. Ai menaxhon detyrat financiare dhe administrative, mbikëqyr aktivitetet financiare, përmbush kërkesat e dekanit, adreson nevojat akademike dhe administrative, si dhe mbikëqyr konferencat dhe seminarët për programet e fakultetit.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ, duke ju referuar RVB, evidenton se Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Bordi Drejtues i WBU vlerëson dhe miraton rregulloren financiare të institucionit, përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave vetanake që siguron universiteti dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. Mbikëqyrja bëhet përmes rishikimit periodik të buxhetit dhe rialokimit të fondeve sipas nevojës. Monitorimi i shpërndarjes dhe menaxhimit të burimeve financiare bëhet në përputhje me kornizën aktuale ligjore në Shqipëri dhe me standardet shqiptare të kontabilitetit. Mënyra e përdorimit të fondeve për çdo vit akademik, përshkruhet në Raportin Vjetor Institucional, i cili publikohet në faqen zyrtare. WBU përmban edhe Zyrën e Financës, e cila është përgjegjëse për përgatitjen e planprogramit buxhetor. Komponenta të rëndësishme buxhetore janë edhe fitimet në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, rritja e numrit të studentëve, hapja e programeve të studimit të kekruara nga tregu, etj.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU;</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Veprimtaria vjetore akademike dhe financiare e WBU përmbledhet në një raport vjetor që miratohet nga trupat udhëheqese të institucionit. Raportet financiare përgatiten çdo vit. Buxheti përgatitet bazuar në projekte dhe kërkesat financiare të njësisë përbërëse. WBU kryen auditime të brendshme dhe të jashtme për të vlerësuar efektivitetin e financimit dhe burimeve financiare. Administratori i fakultetit menaxhon detyrat financiare dhe administrative, ndërsa Bordi Drejtues vlerëson dhe miraton rregulloren financiare dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e WBU specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kriteret e pranimit për ciklin e dytë, përfshijnë aftësinë në gjuhën angleze për programin Master i Shkencave dhe kërkojnë miratimin e Senatit Akademik, me shpallje publike nga njësia kryesore.</p> <p>Gjithashtu WBU ka përcaktuar në aktet e brendshme rregullat dhe kërkesat për provimet. Studenti vlerësohet nga pedagogu në fund të semestrit. Për tu diplomuar, studenti duhet të ketë mesatare mbi 7. Studenti kalon nga viti i parë në të dytin me të paktën 30 kredite dhe nga viti i dytë në të tretin me të paktën 60 kredite nga vitet paraardhëse. Studenti që përmbush të gjitha detyrimet akademike ka të drejtë të hyjë në provimin e diplomës.</p> <p>Evidenca Nr.5.1 Miratimi i kriterëve të pranimit për programet e Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit:</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit janë transparente dhe bëhen të njohura publikisht. Gjatë ciklit akademik aket rregullatore të institucionit kanë parashikime që mundësojnë barazi dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët e programit të studimit. Respektimi me rigorozitet i këtyre rregullimeve nga strukturat e institucionit dhe personeli akademik, mundëson respektimin e parimit të barazisë dhe garantimit të të drejtave në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët që ndjekin këtë program.</p> <p>Për studentët e huaj, WBU ka procedura me kriteret specifike pranimi. Në vitin akademik 2023-2024 janë regjistruar 28 studentë të huaj.</p> <p>Evidenca Nr.5.2 Procedura e pranimit të studentëve të huaj;</p> <p>Evidenca Nr.5.3 Lista e studentëve të huaj gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe 2023-2024;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Pranimi dhe regjistrimi në programin e studimit bëhet në përputhje me rregullimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Aktet rregullatore të institucionit gjithashtu kanë përcaktuar kriteret e pranimit në varësi të ciklit të studimit. Referuar <i>nenit 12</i> të Rregullores së programeve të ciklit të dyte, kanë të drejtë të aplikojnë për tu regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë;</li> <li>- si dhe plotësojnë standartet akademike të kriterëve të pranimit të WBU;</li> </ul> <p>Këto kriteret miratohen nga Senati Akademik. Të gjithë aplikantët që pranohen në programin e studimit Master i Shkencave, duhet të jenë njohës të mirë të gjuhës angleze vërtetuar me certifikata ndërkombëtare. Kandidatët që kanë kryer studimet universitare në gjuhën angleze përjashtohen nga kërkesa për njohje të gjuhës angleze.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU-së;</p> <p>Evidenca 1.3 Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit;</p> <p>Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve të ciklit të dytë;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe</p>	<p>WBU ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore, përfshirë Statutin, rregulloret e brendshme si dhe akte të tjera</p>



<p>përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>normative të cilat disiplinojnë të gjitha spektet e jetës universitare. Në përmbajtjen e tyre ka parashikime mbi procedura dhe rregullime që i referohen mbarëvajtjes së këtij program studimi. Aktet rregullatore parashikojnë kritere e procedura të pranimit dhe regjistrimit të studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimor, vlerësimit të dijeve, transferimit të studimeve, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme etj. Studentët informohen mbi procedurat e vlerësimit qysh në javën e parë të ciklit të studimeve, nëpërmjet Sesioneve të Orientimit Akademik dhe në javën e parë për çdo lëndë gjatë prezantimit të syllabusit. Për çfarëdo problemi specifik, studentët mund të kërkojnë informacion nga këshilltari akademik, koordinatori i programit dhe përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU; Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU; Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve te ciklit te dyte;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të vitit akademik institucioni merr masa paraprake dhe organizon aktivitete informuese mbi programet e studimit që ofron. Institucioni organizon ditët orientuese ku të ninteresuarit njihen me komponentët e programit të studimit, por edhe me aspektet organizative dhe administrative që i referohen programit. Gjithashtu, bëhen publike edhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në programet që institucioni ofron. Kritere të veçanta për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve në programin Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor janë hartuar nga Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financa. WBU gjithashtu merr pjesë në panairë të ndryshme të informimit për arsimin e lartë, duke ju ofruar mundësinë të interesurave të marrin informacionet e nevojshme për regjistrim. Komunikimi zhvillohet edhe përmes platformave online.</p> <p>Evidenca Nr.4.37 Ditët e informimit brenda institucionit për studentëtorganizimi i aktiviteteve informuese;</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të</p>	<p>Referuar RVB, WBU pranon edhe studentë me aftësi të veçanta, studentë nga pakicat dhe nga shtresat e marginalizuara. Ky proces bëhet përmes kuotave të veçanta dhe mbajtjes së seminareve për ndërgjegjësimin e studentëve. Në godinën kryesore të institucionit ka infrastrukturë të veçantë për përdorimin e mjeteve ndihmëse për këtë kategori</p>



<p>pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>sociale të veçantë dhe shfrytëzimin e hapësirave të veçanta (ashensori, nyjet sanitare).</p> <p>Evidenca Nr.5.5 Kuotat e parashikuara për studentët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara;</p> <p>Evidenca Nr.5.6 Raport Trajnimi WBU-Down Syndrome Albania;</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Kriteret për pranimin e kandidatëve nga shtete të tjera janë përcaktuar në Rregulloren Themelore të WBU. Kuotat e pranimi për studentët ndërkombëtarë janë të limituara dhe pranimi varet nga edhe nga miratimi prej MAS. Në dispozicion të studentëve të huaj janë dy zyra të posaçme, Zyra e Marketingut dhe Pranimeve si dhe Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve. Studentët e huaj kanë të gjitha informacionet akademike, ekonomike dhe ato të jetesës në Shqipëri.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU;</p> <p>Evidenca Nr.5.1 Miratimi i kriterëve të pranimi për programet e Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit;</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>WBU publikon dhe përditëson periodikisht të dhënat në lidhje me tarifat e studimit, kategoritë e bursave dhe bursat nga institucionet partnere. Institucioni ofron mbështetje për studentët e kategorive të ndryshme përmes bursave të ekselencës, bursave institucionale, si dhe bursave të studimit për maturantët që vijnë nga zona të veçanta të vendit. WBU, po ashtu, harton politika të ndihmës për studentët me kushte të vështira.</p> <p>Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative;</p> <p>Evidenca Nr.5.7 Marrëveshja me perspektivat e reja për bursat;</p> <p>Evidenca Nr.5.8 Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit Ëestern Balkans;</p> <p>Evidenca Nr.5.9 Lista e studentëve përfitues të bursave për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024;</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Pranimi i studentëve në WBU bazohet në procedurat ligjore dhe institucionale. WBU pranon studentë ndërkombëtarë dhe</i></p>

	<p>nga kategori të veçanta sociale, me procedura të veçanta pranimi dhe kuota të rezervuara. Informacionet për programet, tarifaf, bursat, dhe kriteret e pranimit publikohen në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p>Institucioni ofron mbështetje për studentët përmes bursave dhe politikave ndihmëse për shtresat në nevojë. WBU gjithashtu organizon aktivitete informuese dhe merr pjesë në panairë të arsimit për të ofruar informacion mbi programet e tij.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Aktet e brendshme normative të institucionit kanë rregullime mbi të gjitha aspektet që lidhen me përparimin akademik të studentëve. Rregulloret që i referohen programit kanë parashikime mbi përmbajtjen e programit të studimit, procesin mësimor, frekuentimin dhe vlerësimin e dijeve. Informacione të detajuar për procedurat e përparimit akademik të studentëve, bazohen në Statutin e WBU (sasia e krediteve së paku 60 kredite, që përkon me 1500 orë pune). Kalimi nga një vit në tjetrin bëhet pasi që studenti të ketë shlyer detyrimet e vitit të mëparshëm, sipas Rregulloreve të WBU.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU-së.pdf;</p> <p>Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve te ciklit te dyte;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të</p>	<p>Institucioni informon studentët për kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesshme, sipas Statutit të WBU dhe rregulloreve përkatëse. Ata që janë të interesuar për të transferuar dhe ndjekur studimet në një nga programet e studimit të WBU marrin informacion mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e</p>

<p>mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>kualifikimeve të mëparshme. Njohja e krediteve kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur për këtë qëllim nga departamenti përgjegjës për programin e studimit, në përputhje me objektivat specifike dhe kurrikulën e programit përkatës.</p> <p>Evidenca Nr.5.10 Rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve;</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU;</p> <p>Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve te ciklit te dyte;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale-shkencore të studentëve bazohet në Rregulloren e Themelore të WBU, dhe në Rregulloren "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë". Në fillim të vitit për çdo lëndë, studentët informohen me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara nga titullari i lëndës. Syllabusi i lëndës ngarkohet në platformën Smart WBU <a href="https://smart.WBU.edu.al">https://smart.WBU.edu.al</a> dhe në Google Classroom dhe studentët e atij programi studimor mund të informohen në çdo kohë.</p> <p>Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve te ciklit te dyte;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka formalizuar procedurat që lehtësojnë rrugëtimin universitar të studentëve, që nga regjistrimi në program, e deri në diplomim. Studentët njohohen me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Diploma është përcaktuar si lëndë e veçantë me një numër të caktuar kreditesh. Modalitetet mbi detyrimet përmbyllëse të studentëve janë përcaktuar në Statutin e WBU, Rregulloren Themelore të WBU dhe Manualin për punimin e diplomës. Në këtë proces studentit i dalin në ndihmë edhe drejtuesit e lëndës, mësimdhënësit dhe këshilltarët akademikë. Në hartimin e tezës së masterit, studenti ka në dispozicion edhe një udhëheqës shkencor.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU;</p>

	Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve te ciklit te dyte;			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Zyra e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve është përgjegjëse për prezantimin, pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të ardhshëm. Kjo zyrë e prezanton WBU në panaire të ndryshme përmes materialeve promovuese, siç është Guida e Studentit. Institucioni shpërndan informata të detajuara për të interesuarit edhe përmes komunikimit digjital - faqja e internetit dhe rrjetet sociale të universitetit (Facebook, Instagram). Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve në fillim të çdo viti akademik, organizon javën orientuese për studentët e rinj, duke i njohur ata me informacionet e nevojshme për jetën akademike dhe studentore. Informimi dhe mbështetja e studentëve vazhdon përgjatë tërë vitit akademik. Strukturat e njësisë bazë dhe kryesore, me anë të këshilltarit akademik, mbikqyrin vijueshmërinë e suksesshme akademike të studentëve.</p> <p>Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrativ; Evidenca Nr.4.38 Guida e studentit; Evidenca Nr.5.11 Raport mbi veprimtarinë e Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentët për vitin akademik 2022;</p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>WBU informon studentët për procedurat e përparimit akademik. Njohja dhe transferimi i kualifikimeve të mëparshme bëhet nga komisione të posaçme. Kriteret e vlerësimit dhe metodologjitë e testimit komunikohen në fillim të vitit akademik dhe syllabusi i çdo lënde është i disponueshëm në platformën Smart WBU dhe Google Classroom. Procedurat e punimit të diplomës janë të formalizuara dhe studentët mbështeten nga udhëheqës shkencorë dhe këshilltarë akademikë. Zyra e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve menaxhon informimin dhe pranimin e studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët e këtij program studimi marrin informacion të detajuar mbi komponentët e programit nëpërmjet një sërë burimesh si pedagogu i lëndës, Sekretaria Mësimore, aketet rregullatore apo informacionet e publikuara nga institucioni. Në fillim të vitit akademik studentët informohen nga pedagogët e lëndës në lidhje me përmbajtjen dhe detyrimet e lëndës. Në çdo departament emërohet nga një këshilltar akademik dhe roli i tij është të mbështesë studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve të tyre në universitet. Ata kanë rol të rëndësishëm në mbështetjen e studentëve.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Western Balkans;</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</p> <p>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të dytë";</p> <p>Evidenca 5.12. Procedura e regjistrimit të studentëve;</p> <p>Evidenca 5.13. Praktika e informimit të studentëve nga këshilltari akademik i programit Master i Shkencave "Menaxhim Spitalor";</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Studentët e marrin këtë informacion në Kurrikulën e Programit si dhe në rregulloren e posaçme mbi këtë cikël studimesh. Njëkohësisht në syllabuset e lëndëve gjendet informacion mbi përmbajtjen e lëndëve, objektivat formues si dhe format e vlerësimit të njohurive. Të gjitha planet mësimore janë edhe në dy gjuhët në faqen e internetit të institucionit përmes platformës SMART WBU. Përmes kësaj platforme studenti ka qasje në kohë reale për çdo hollësi të programit të studimit. Vijueshëmria dhe suksesi i studentëve mbikëqyren nga këshilltarët akademikë.</p> <p>Evidenca Nr.4.38 Guida e studentit;</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si	Në fillim të studimeve, studentët njoftohen me mundësitë e punësimit për çdo program studimi. Këtë punë e kryen Zyra e Planifikimit të Karrierës, e cila krijon lidhje institucione

<p>dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>publike dhe private, në vend dhe jashtë për t'i orientuar studentët drejt tregut të punës. Studentët mbajnë edhe trajnime profesionale, dhe aftësohen për përgatitjen e CV profesionale, hartimin e Letrës së Motivimit dhe sjelljet gjatë intervistave për punë. Zyra e Planifikimit të Karrierës mban edhe takime këshillimore individuale dhe grupore dhe orienton studentët për karrierën e tyre profesionale (p.sh. Career Workshop, Career Fair).</p> <p>WBU ofron edhe informata për nxënësit e shkollave të mesme dhe të interesuarit e tjerë për t'u njohur më hollësisht për programet e studimit, mundësitë e bursave dhe të gjitha shërbimet tjera që ofrohen në WBU.</p> <p>Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative; Evidenca 5.14 Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët mund ta aksesojnë këtë informacion që në momentin e parë të regjistrimit, nëpërmjet veprimtarive orientuese apo informuese që organizon institucioni. Sekretaria mësimore u jep studentëve çdo informacion të nevojshëm mbi organizimin e procesit mësimor. Personeli dhe studentët janë të pajisur me adresa zyrtare të komunikimit të brendshëm elektronik. Përmes faqes së internetit dhe platformës Smart WBU (<a href="https://smart.WBU.edu.al/">https://smart.WBU.edu.al/</a>), studentët kanë qasje në çdo detaj për programin e studimit, materialet didaktike, vlerësimet, etj. Në programet e studimit janë të parashikuara oraret dhe klasat e takimit të studentëve me secilin pedagog.</p> <p>Evidenca Nr.5.13 Praktika e informimit të studentëve nga këshilltari akademik i programit Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet platformës SMART WBU, institucioni mundëson një sistem efikas të menaxhimit të informacionit, i cili ofrohet në shqip dhe anglisht dhe mund të qaset nëpërmjet llogarive personale të studentëve. Çdo informacion lidhur me programet e studimit është lehtësisht i qasshëm nga studentët edhe në distancë.</p>

<b>Konkluzione</b>	<i>WBU informon studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Statuti dhe rregulloret e WBU përcaktojnë organizimin e studimeve. Studentët informohen për lëndët dhe përmbajtjen e tyre përmes Guidës së Studentit. Zyra e Planifikimit të Karrierës lidh studentët me tregun e punës dhe ofron trajnime për aftësitë profesionale. Informacioni për studentët është lehtësisht i qasshëm përmes komunikimit elektronik dhe platformës SMART WBU.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>																	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>																	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	WBU nëpërmjet strukturave të tij, disponon dhe administron statistika vjetore mbi numrin e studentëve të diplomuar. Në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi si dhe ato të akteve rregullatore të institucionit, Sekretaria Mësimore administron një regjistër të veçantë, regjistrin e të diplomave i cili përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar me sukses programin e studimit dhe janë diplomuar. Ky program studimi është në proces dhe studentët e parë do të diplomohen në fund të vitit akademik 2023-2024.  Evidenca Nr.5.15 Lista e studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor 2022-2023 dhe 2023-2024;																
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me	Në kuadrin e kompetencave të saj, Sekretaria Mësimore administron dokumentacionin me të dhënat e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon:  <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr i të regjistruarve</th> <th>Nr i të cregjistruarve</th> <th>Nr aktual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>10</td> <td>0</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>10</td> <td>2</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td colspan="3"><b>18 studentë</b></td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual	2022-2023	10	0	10	2023-2024	10	2	8	<b>Totali</b>	<b>18 studentë</b>		
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual														
2022-2023	10	0	10														
2023-2024	10	2	8														
<b>Totali</b>	<b>18 studentë</b>																



<p>sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Evidenca Nr.5.15 Lista e studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor 2022-2023 dhe 2023-2024:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të gjitha të dhënat statistikore që u referohen studentëve administrohen jo vetëm në format të dokumentuar, por edhe elektronik. Këto të dhëna regjistrohen edhe në sitemin e brendshëm interaktiv të menaxhimit të informacionit, sitemin SMART WBU. Ky informacion administrohet nga strukturat kompetente në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar.</p> <p>Evidenca Nr.3.27 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore:</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB WBU kryen auditime të brendshme për të siguruar përputhshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore dhe akteve të brendshme të njësive përgjegjëse për menaxhimin. Një element i rëndësishëm është edhe saktësia e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm përmbledhen në një raport, i cili vihet në dispozicion të strukturave drejtuese për adresimin e gjetjeve të raportit dhe ndërmarrjen e masave përkatëse.</p> <p>Evidenca Nr.4.36 Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të</p>	<p>Sekretaria Mësimore administron të dhënat e studentëve si dhe dokumentacionin mbi numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit për çdo vit akademik. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore administron të dhëna që i referohen cilësisë së studentëve në hyrje në fazën e regjistrimit në këtë program studimi.</p> <p>Për sa i takon cilësisë së studenteve gjatë procesit mësimor, Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financave harton raporte analitike që i referohen pjesëmarrjes dhe rezultateve të vlerësimit të studentëve në secilën lëndë. Në këto raporte</p>

përmirësimin të këtyre treguesve.	pasqyrohen edhe komentet dhe konkluzionet që rezultojnë nga këto të dhëna. Këto raporte shërbejnë si një premisë mbi analizat që i referohen cilësisë së mësimdhënies dhe marjen e masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë.			
	Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative; Evidenca 1.20 Raporti Vjetor i Punës Kërkimore; Evidenca Nr.3.27 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore;			
<b>Konkluzione</b>	<i>WBU administron dhe ruan të dhëna të detajuara për studentët e programit Master i Shkencave në Menaxhim Spitalor. Të dhënat për studentët përfshihen në raportet vjetore të njëjësive bazë dhe të nivelit institucional. Sekretaria Mësimore menaxhon dhe arkivon dokumentacionin, i cili është dixhitalizuar. Auditimet e brendshme sigurojnë përputhshmërinë me aktet ligjore dhe akte të brendshme. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financave përgatit raporte analitike periodike mbi cilësinë dhe rezultatet e studentëve, të cilat përdoren për përmirësimin e programeve të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	E drejta e organizimit të studentëve në këshilla studentore dhe përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse është e paraparë me Rregulloren Themelore të WBU. Senati Akademik i WBU-së ka në përbërjen e vet 2 studentë, të cilët përfaqësojnë Këshillin Studentor. Studentët janë të përfaqësuar edhe në komisionet e përhershme në institucion, përfshirë edhe NjsBC. Përmes Zyrës së Koordinimit të Klubeve Studentore dhe Dekanatit të Studentëve, mundësohet organizimi i klubeve studentore në fusha të ndryshme akademike, sociale, kulturore, artistike dhe sportive. Në vitin e parë akademik të studimeve, funksionojnë më shumë 10 klube studentore.

	<p>Evidenca 1.2 Rregullorja Themelore e WBU:</p> <p>Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative:</p> <p>Evidenca Nr.5.21 Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale:</p> <p>Evidenca Nr.5.22 Emërimi i studentit në NJSBC:</p> <p>Evidenca Nr.5.23 Praktika e Zgjedhjeve e Këshillit Studentor 2022:</p> <p>Evidenca Nr.5.24 Raporti i aktiviteteve të Klubeve Studentore 2022-2023 dhe 2023-2024;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Referuar RVB, Këshilli Studentor i WBU është një organ kyç në përfaqësimin e interesave të studentëve në institucion. Zgjedhja e këshillit bëhet me parime demokratike dhe synimi i tij është përfaqësimi studentor pa dallim ideje, feje, gjinie, race apo origjine. Këshilli nuk merret me aktivitet politik apo ekonomik dhe nuk mund të përfshihet në struktura të tjera jashtë institucionit. Bazuar në Rregulloren mbi Organizimin Administrativ të WBU, kryetari i këshillit studentor përfaqëson studentët në organet vendimmarëse të WBU. Studentët shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm për studentet.</p> <p>Evidenca 1.11 Rregullorja mbi organizimin administrative:</p> <p>Evidenca Nr.5.17 Ngritja, funksionimi dhe përbërja e këshillit studentor:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në kuadrin e të drejtave të tyre, Statuti ka sanksionuar të drejtën e studentëve të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në kuadrin e kompetencave të saj në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo lëndë të programit të studimit. Këto pyetësore shërbejnë më tej në procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe në vendimmarrjen e Departamentit mbi aspekte që lidhen me programin e studimit</p> <p>Evidenca Nr.5.16 Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Baz</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullat dhe detyrimet e provimeve, si dhe ankimimi i rezultateve, janë të përcaktuara qartë nga institucioni përmes rregulloreve institucionale. Në javën e parë të çdo semestri, pedagogët publikojnë sistemin e vlerësimit për lëndët përkatëse. Rezultatet e provimeve ju dorëzohen organeve administrative të departamentit brenda afatit të caktuar. Nëse studenti nuk është i kënaqur me rezultatin, ai mund të ankohet me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. Ankimimi shqyrtohet nga një komision i ngritur me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës brenda tre ditësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit brenda 15 ditësh nga paraqitja e kërkesës për rishikim.</p> <p>Evidenca 2.1 Rregullorja e programeve te ciklit te dyte</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>E drejta e organizimit të studentëve në këshilla studentore dhe përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse është e paraparë në Rregulloren Themelore të WBU. Studentët marrin pjesë edhe në komisionet e përhershme dhe NjSBC. Zyra e Koordinimit të Klubeve Studentore dhe Dekanati i Studentëve mbështesin organizimin e klubeve studentore në fusha të ndryshme. Studentët vlerësojnë periodikisht performancën e pedagogëve dhe përmbajtjen e lëndëve. Rregullat për provimet dhe ankimimet janë të qarta për studentët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe</p>	<p>Statuti i Universitet dhe aktet e brendshme rregullatore kanë parashikuar struktura dhe procedura në funksion të informimit të studentëve. Struktura të tilla janë Sekretaria Mësimore, dhe Departamenti si njësi përgjegjëse për administrimin e procesit akademik që i referohet këtij program studimi.</p>

<p>aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjithashtu WBU ka një sistem të menaxhimit që bazohet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Ky menaxhim përcaktohet në Statutin e WBU, Rregulloren Themelore dhe Rregulloren mbi organizimin administrativ. Universiteti ruan edhe kopjet fizike dhe elektronike të dokumentacionit të studentëve sipas dispozitave ligjore. Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës është përgjegjëse për arkivimin dhe administrimin e dokumenteve të krijuara në institucion. Sekretaria Mësimore monitoron dhe arkivon çdo regjistrim dhe informacion lidhur me studentët. Kurse, Platforma SMART WBU dixhitalizon dokumentacionin dhe siguron trajtimin e të dhënave sipas kërkesave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Western Balkans;  Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;  Evidenca 1.11. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans;  Evidenca 3.26. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;  Evidenca 3.27. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>WBU ka struktura të dedikura për ndjekjen dhe asistimin e studentëve si dhe një sistem menaxhimi për ofrimin e informacionit mbi procesin mësimor dhe programin e studimit. Për komunikimin, WBU ka krijuar Zyrën e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimin e Studentëve, nën varësi të Dekanatit të Studentëve.</p> <p>Stafi administrativ dhe zyrat e dedikuara si Dekani i Studentëve gjithashtu mbështesin dhe asistojnë studentët në çështje të administrimit të procesit mësimor. Studentët marrin informacion edhe nëpërmjet aksesit në sistemin e menaxhimit të informacionit dhe përdorimit të platformës SMART WBU. Institucioni ka hartuar udhëzues të posaçëm për informimin e studentëve mbi të gjitha aspektet e jetës akademike. Njoftimet, thirrjet publike dhe aktivitetet e ndryshme publikohet në faqen zyrtare (<a href="http://www.WBU.edu.al">www.WBU.edu.al</a>) dhe në rrjetet sociale. Të gjitha procedurat për aplikimin për bursa janë publikuar online. Përveç SMART WBU, përdoret platforma Google Classroom për komunikim dhe ngarkimin e</p>

	<p>materialeve mësimore, dhe studentët mund të kontaktojnë në çdo kohë Dekanatin e Studentëve.</p> <p>Evidenca 1.11. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës, i orienton studentët në tregun e punës si dhe zhvillimin e karrierës. Nëpërmjet marrëdhënieve të bashkëpunimit me biznese, institucione private e shtetërore kjo zyrë mundëson krijimin e oportuniteteve të punësimit. Zyra i ndihmon dhe mbështet studentët në procesin e kërkimit të punës dhe punësimit nëpërmjet trajnimeve profesionale.</p> <p>Evidenca 1.11. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Eastern Balkans;</p> <p>Evidenca Nr.5.14 Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës;</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>WBU ka edhe Zyrën e të Diplomuarve që bën gjurmimin e të diplomuarve në tregun e punës, krijimin e një rrjeti të gjerë të komunikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme me ta. Kjo zyre përcjell studentët pas diplomimit, mbledh dhe analizon të dhënat mbi punësimin e studentëve dhe informon studentët dhe organet drejtuese.</p> <p>Evidenca 1.11. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Eastern Balkans;</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>WBU ka një sistem të menaxhimit të bazuar në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, duke dixhitalizuar dhe ruajtur dokumentacionin e studentëve. Zyra e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun publikon informacione në web dhe rrjetet sociale. Dekanati i Studentëve ofron mbështetje për studentët përmes Zyrës së Orientimit dhe Mbështetjes, dhe Zyrës së Planifikimit të Karrierës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>WBU ofron metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Sipas Rregulloreve të institucionit, procesi mësimor përfshin leksionet, punët në laborator, praktikat mësimore, vizitat studimore, seminarët, testet e shkruara, punët individuale dhe praktikat. Personeli kombinon këto alternativa të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Institucioni ka një qasje moderne ndaj përdorimit të pajisjeve dhe teknologjive, duke pajisur të gjitha sallat dhe ambientet me smartboard, projektorë dhe kompjuterë. Sistemi i mësimdhënies dhe mësimnxënies në WBU synon përmirësimin e cilësisë së mësimin dhe të nxënies për studentët.</p> <p>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</p> <p>Evidenca 1.9. Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;</p> <p>Evidenca 2.1. Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të dytë";</p> <p>Evidenca 3.14. Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU;</p> <p>Evidenca 3.15. Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART WBU;</p> <p>Evidenca 3.2. Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien;</p>

	Evidenca 3.3. Pyetësor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrative:
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, Insitucioni ka zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Ky aktivitet mundësohet nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, i cili bashkërendon punën e tij me NJSBC. Funkcionimi i NJSBC përcaktohet në rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati Akademik. Njësia kryen vlerësime të pavarura duke u bazuar në të dhëna të sakta, objektive dhe të larmishme. Senati Akademik i WBU vlerëson, garanton dhe mbikëqyr sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore.</p> <p>Evidenca 1.1 Statuti i WBU;</p> <p>Evidenca 2.8. Paketa e instrumenteve të cilësisë;</p> <p>Evidenca 3.8. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit;</p> <p>Evidenca 3.10. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</p> <p>Evidenca 3.11. Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC;</p> <p>Evidenca 3.12. Plani i aktiviteteve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</p> <p>Evidenca 3.13. Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Vlerësimi i metodave dhe aftësive të mësimdhëniesë të stafit akademik është pjesë përbërëse e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Institucioni vlerëson në fund të çdo semestri cilësinë e çdo program/moduli si dhe aftësinë e mësimdhënies. Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmash të vlerësimit të cilësisë ku mundësohet edhe përfshirja dhe shprehja e opinionit të studentëve. Instrumenti kryesor në këtë drejtim janë pyetësorët e vlerësimit të modulit të studentëve, një pjesë e mirë e përmbajtjes së të cilëve i referohet procesit të mësimdhënies. Në këto sondazhe studentët japin komentet dhe vlerësimet e tyre mbi aspekte të procesit të mësimdhënies</p>



	<p>si niveli i përgatitjes dhe njohurive, aftësia dhe metodat e mësimdhënies. Studentët kanë të drejtën edhe të ankimit të rezultateve të vlerësimit të tyre nga pedagogët.</p> <p>Evidenca Nr.3.6 Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</p> <p>Evidenca Nr.6.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni përdor një sërë mekanizmesh të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies si sondazhet e studentëve, monitorimi nga Departamenti etj. Rezultatet që vijnë nga proceset e vlerësimit të cilësisë janë pjesë e raporteve që i referohen veprimtarisë së strukturave akademike në kuadrin e sigurimit të cilësisë. Si të tilla këto raporte si dhe rezultatet e vlerësimit i bëhen të njohura stafit akademik. Njëkohësisht edhe studentët kanë të drejtë të njihen me konkluzionet dhe rekomandimet që rezultojnë nga procesi i anketimit si dhe masat e marra në këtë drejtim. Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe raportet e njëjësive të ngarkuar me mbikqerjen dhe vlerësimin e cilësisë bëhen publike në faqen web të institucionit. Njësitë bazë dhe kryesore mbajnë dhe drejtojnë përgjegjësitë për personelin lidhur me procesin e vlerësimit, performancën e arritjeve, aktivitetet promovuese dhe bazuar në formulën e vetëvlerësimit të stafit.</p> <p>Evidenca Nr.6.2 Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC;</p> <p>Evidenca Nr.6.3 Rast i një veprimtarie të organizuar për informim dhe ndërgjegjësim për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Evidenca Nr.6.4 Formular i vetëvlerësimit të stafit;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni përdor mekanizma të vlerësimit të performancës akademike dhe veprimtarisë administrative të stafit të përfshirë në programin e studimit. Për këtë qëllim janë hartuar direktiva të posaçme mbi kriteret dhe mekanizmat e vlerësimit të performancës, si "Guidën e stafit", Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit. Në përmbajtjen e direktivave janë parashikuar aspekte që i referohen nxitjes së përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe promovimit të praktikave më të mira në</p>

	<p>vlerësimin e performancës së personelit akademik. WBU po ashtu i kushton vëmendje mbështetjes financiare të stafit në fushën e kërkimit shkencor. Në fillim të çdo viti akademik zhvillohen ditët orientuese me qëllim të lehtësimit të integritit të stafit të institucionit për vitin e ri akademik. WBU i ofron personelit të tij edhe mundësinë për të avansuar kualifikimet e tyre në fusha të ndryshme.</p> <p>Evidenca 2.18 Model i Mbështetjes Financiare të Personelit;</p> <p>Evidenca 2.19 Udhëzimi për Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor;</p> <p>Evidenca Nr.4.11 Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</p> <p>Evidenca Nr.6.5 Guida e Stafit;</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>WBU ofron forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies. Komisioni i Përherëshëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë monitoron dhe vlerëson periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit, duke përfshirë vlerësimet e studentëve. Politikat e sigurimit të cilësisë janë transparente dhe bëhen publike, me raportet e vlerësimit dhe masat për përmirësim. Institucioni zbaton politika për promovimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të stafit, duke ofruar mbështetje financiare dhe mundësi për avansim akademik.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi	WBU e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në Statutin, aktet rregullatore si dhe Ligjin nr.80/2015 dt. 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i komponentëve të saj është pjesë e objektivave zhvillimore të Universitetit. WBU pasqyron politikat e tij të sigurimit të

<p>dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>cilësisë në dokumenta ku parashikohen parimet dhe standartet e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Sipas Statutit të WBU-së, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, aktet të cilat miratohen nga Senati Akademik. Ky komision bashkërendon punën e tij me NJSBC. Veprimtaria e NJSBC parashikohet në Statutin e WBU dhe në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e NJSBC.</p> <p>Evidenca 2.8 Paketa e Instrumentave të Cilësisë;</p> <p>Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale;</p> <p>Evidenca 3.9. Vendimi për ngritjen e NJSBC;</p> <p>Evidenca 3.10. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</p> <p>Evidenca 4.14. Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</p> <p>Evidenca 5.22. Emërimi i studentit në NJSBC;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të komponentëve kryesore të cilësisë, Institucioni ka hartuar paketën e instrumentave të cilësisë, ku pasqyrohen vizioni dhe misioni i Institucionit në sigurimin e cilësisë si dhe parimet dhe metodat për sigurimin e cilësisë. Kjo paketë detajon organizimin strukturor të sistemit të sigurimit të cilësisë, organet përgjegjësie, kompetencat dhe procedurat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Njësia bazë angazhon dhe ekspertët të jashtëm në hartimin e kurrikulave, shqyrtimin e literaturës apo propozimet për programet e reja të studimit. Përfaqësuesi i studentëve, ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e organizuara nga njësia, me qëllim transmetimin e opinionit dhe mendimit të studentëve. Institucioni në kuadër të vlerësimit, realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së programeve, përdor edhe metoda të tërthorta përmes pjesëmarrjes dhe kontributit të strukturave studentore (Dekani i Studentëve, Këshilli Studentor apo Klubi i Studentëve).</p>

	<p>Evidenca 2.8. Paketa e Instrumenteve të cilësisë:</p> <p>Evidenca 2.7. Formulari i vlerësimit të programit të studimit nga studentët që diplomohen:</p> <p>Evidenca 3.11. Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC:</p> <p>Evidenca 3.12. Plani i aktiviteteve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</p> <p>Evidenca 3.13. Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023:</p> <p>Evidenca 5.16. Praktikë mbledhje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit Njesisë Bazë:</p> <p>Evidenca 5.21. Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale:</p> <p>Evidenca 6.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët;</p> <p>Evidenca 6.9. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>WBU në vizionin dhe misionin e vet, thekson se garantimi i cilësisë është objektivi kryesor. NJSBC ka hartuar një plan masash dhe strategjish për monitorimin dhe vlerësimin periodik të rezultateve të arritura në fushën e kërkimit shkencor, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve sociale e kulturore, etj. Në përfundim të vlerësimit, NJSBC jep rekomandime përkatëse. Përmirësimi i programeve të studimit kryhet përmes indikatorëve të caktuar. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes të proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit.</p> <p>Evidenca 2.8. Paketa e Instrumenteve të cilësisë:</p> <p>Evidenca 3.11. Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC:</p> <p>Evidenca 6.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët:</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe</p>	<p>NJSBC ka përgatitur një pako të instrumenteve të cilësisë, përmes të cilëve vlerëson performancën e personelit akademik. Vlerësimi bëhet duke u bazuar në tregues të matshëm për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore. Format e vlerësimit janë</p>

<p>dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>të ndryshme, si p.sh vlerësimi i studentëve për performancën e pedagogut, vlerësimi nga kolegët, vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit, si dhe vetëvlerësimi i performancës. Të dhënat e fituara shqyrtohen nga komisionet vlerësuese të njësive përkatëse. Çdo anëtar i personelit merr informatë për rezultatet e tij dhe njihet me komentet dhe sugjerimet e studentëve, në zarf të mbyllur. Treguesit e cilsisë merren për bazë në promovimin akademik të personelit brenda njësive bazë dhe njësive kryesore akademike.</p> <p>Evidenca 1.9. Lista e trajnimeve të zhvilluar për stafin gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;</p> <p>Evidenca 2.19. Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor;</p> <p>Evidenca 3.6. Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</p> <p>Evidenca 4.11. Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</p> <p>Evidenca 6.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët;</p> <p>Evidenca 6.4. Formular i vetëvlerësimit të stafit;</p> <p>Evidenca 6.7. Praktikë e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca;</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>WBU ka hartuar politika dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC) në përputhje me kornizën ligjore dhe aktet rregullatore institucionale. NJSBC monitoron dhe vlerëson cilësinë e programeve, kërkimin shkencor, burimet njerëzore dhe infrastrukturën, duke ofruar rekomandime për përmirësim. Politikat e sigurimit të cilësisë janë transparente dhe publikohen në faqen zyrtare të WBU dhe rezultatet përdoren për promovimin akademik dhe përmirësimin e programeve të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë së programit të studimit është një nga misionet më të rëndësishëm në nivel institucional. Në kuadrin e politikave të vlerësimit të cilësisë institucioni përdor një sërë metodash e procesesh për vlerësimin e cilësisë së programeve që ofron. Vlerësimi i cilësisë së programit realizohet në mënyrë sistematike nëpërmjet proceseve që i shërbejnë rritjes së efektivitetit të tij. Ky proces përfshin një sërë strukturash si Departamenti, Dekanati, NJSBC, strukturave të sigurimit të cilësisë dhe Senati Akademik. Në kuadrin e mbikëqyrjes së programeve të studimit institucioni ka përdorur një sërë metodash, përfshirë edhe feedbackun që merret nga studentët.</p> <p>Këto anketime i referohen vlerësimeve të studentëve edhe në lidhje me kurikulën e programit, performancën e stafit, teknologjive dhe formave të mësimdhënies si dhe infrastrukturës në funksion të programit të studimit. Gjetjet dhe konkluzionet që rezultojnë nga këto sondazhe u referohen Departamenteve përkatëse për marrjen e masave konkrete për përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p>Evidenca 2.7. Formulari i vlerësimit të programit të studimit nga studentët që diplomohen;</p> <p>Evidenca 3.11. Paketa e Instrumentave të cilësisë;</p> <p>Evidenca 6.10. Formular për vlerësimin e personelit akademik nga kolegët:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të</p>	<p>Rezultatet që rjedhin nga proceset e vlerësimit dhe mbikëqyrjes së programeve të studimit dhe cilësisë në tërësi, janë objekt i raporteve të strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, që është NJSBC. Në këto raporte pasqyrohen rezultate e vlerësimit, shembujt e praktikave më të mira si dhe adresimi i mangësive të konstatuara dhe masat për përmirësimin e tyre. Këto raporte shërbejnë për hartimin e planeve të veprimit dhe ndërmarjen e masave konkrete që i referohen përmirësimin të komponentëve të cilësisë.</p>

<p>mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Evidenca 2.19. Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor;</p> <p>Evidenca 3.6. Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</p> <p>Evidenca 4.11. Rregullorja mbi punësimin promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;</p> <p>Evidenca 5.8. Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit Ëestern Balkans;</p> <p>Evidenca 6.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët;</p> <p>Evidenca 6.4. Formular i vetëvlerësimit të stafit;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>WBU përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit të cilësisë, të cilat janë parashikuar në pakon e instrumentave të cilësisë. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit ndërlihet me cilësinë e mësimdhënies, performancën e pedagogut, metodat dhe didaktikën e përdorur në auditor, kurrikulën dhe të mësuarit, vlerësimet paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, etj.</p> <p>Sipas LAL, vlerësimi i studentëve për stafin dhe programin e studimit bëhet 2 herë në vit. Vlerësimi i stafit në performancën e mësimdhënies nga studentët bëhet në mënyrë anonime nëpërmjet platformës SMART WBU, e cila përmban pyetësorë të dedikuar. Të dhënat përpunohen në formë raporti, i cili u bëhet me dije personelit dhe publikut.</p> <p>Evidenca 2.8 Paketa e Instrumentave të Cilësisë;</p> <p>Evidenca 2.9 Raport mbi Pjesëmarrjen në Konferencën Mjekesore;</p> <p>Evidenca Nr.6.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar</p>	<p>Përveç metodave direkte të vlerësimit, WBU përdor edhe metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, siç janë intervistat me studentët e diplomuar, me stafin akademik, ndihmësakademik e administrativ, me punëdhënësit e institucioneve partnere dhe palëve të tjera që përfshihen në vlerësimin e programit. Planifikohet që në përfundim të ciklit dyvjeçar, studentët e programit Master i Shkencave në “Menaxhim Spitalor” që do të diplomohen të bëjnë vlerësimin e programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve specifikë</p>


<p>(alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>(pyetjet me përgjigje të mbyllura dhe të hapura). Këto vlerësime do të përdoren nga fakulteti dhe menaxhmenti për të përmirësuar kurrikulën dhe për të rritur cilësinë e realizimit të programit të studimit. Ndryshimet eventuale të programit miratohen nga Senati akademik.</p> <p>Evidenca 2.7 Formulari vleresimit te programit nga studentet: Evidenca Nr.5.9 Lista e studentëve përfitues të bursave për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024:</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>WBU përdor mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen e programit të studimit. NJSBC evidenton arritjet dhe mangësitë e programit, duke hartuar aktivitete për përmirësim.</i></p> <p><i>Vlerësimet periodike nga studentët dhe stafi akademik për performancën dhe cilësinë e mësimdhënies shërbejnë për raportime dhe përmirësime të mëtejshme. Institucioni përdor edhe metoda të tërthorta për të vlerësuar programin.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të</p>	<p>Institucioni mundëson angazhimin e një sërë aktorësh në procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe aksesimin e kontributeve të gjithsecilit në këtë proces. WBU ka ngritur një sistem efikas me një sërë strukturash të brendshme të sigurimit të cilësisë. Përbërja e këtyre strukturave mundëson pjesëmarrjen në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, të personelit akademik, ndihmës administrativ si dhe studentëve. Gjithashtu pjesëmarrja e aktorëve të brendshëm mundësohet edhe nëpërmjet mekanizmave e metodave të tërthorta të vlerësimit</p>



<p>cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>të cilësisë ku mundësohet përfshirja dhe opinion i tyre mbi cilësinë e programeve të studimit.</p> <p>Evidenca Nr.3.8 Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale;</p> <p>Evidenca Nr.4.4 Oferta akademike e WBU 2023-2024;</p> <p>Evidenca Nr.6.9 Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nëpërmjet politikave të sigurimit të cilësisë institucioni përcakton detyra e përgjegjësi konkrete për të gjithë aktorët e angazhuar në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktet e brendshme të institucionit kanë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e stafit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ në këtë proces. Strukturat e sigurimit të cilësisë mbikqyrin angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve në procesin e sigurimit të cilësisë si dhe ushtrimin e këtyre detyrave. Secila strukturë në WBU ka përgjegjësi dhe detyra konkrete në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë konform kornizës ligjore në fuqi dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p>Evidenca 2.8. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë;</p> <p>Evidenca 3.7. Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit;</p> <p>Evidenca 3.8. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit;</p> <p>Evidenca 3.9. Vendimi për ngritjen e NJSBC;</p> <p>Evidenca 3.10. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC;</p> <p>Evidenca 5.22. Emërimi i studentit në NJSBC;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të</p>	<p>Përfshirja e strukturave akademike, ndihmës-akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të cilësisë është pjesë e strategjive institucionale. Aktet rregullatore të brendshme parashikojnë rregullime mbi rolin e Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe Financës si njësi përgjegjëse për këtë program studimi, si dhe atë të personelit akademik,</p>

<p>personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>ndihmës akademik dhe administrativ dhe studentëve në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Stafi akademik i këtij programi studimi çdo vit akademik rishikon syllabusat e lëndëve në lidhje me temat dhe literaturën me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit mësimore. Angazhimi në punë administrative i stafit akademik nxit pjesëmarrjen aktive në procesin e administrimit të programit të studimit dhe vlerëimin e cilësisë së tij. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit përfshin edhe strukturat administrative që ushtrojnë veprimtari në administrimin e këtij programi.</p> <p>Evidenca 2.8. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë:</p> <p>Evidenca 5.16. Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit Njësinë Bazë:</p> <p>Evidenca 6.4. Formular i vetëvlerëimit të stafit:</p> <p>Evidenca 6.9. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja;</p> <p>Evidenca 6.11. Raporti i vlerëimit të institucionit nga personeli për vitin akademik 2022-2023;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerëimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në proceset ciklike të vlerëimit, respektohen integriteti akademik dhe vlerat etike të personelit akademik apo administrativ dhe bëhen publike përmes një qasje transparente. Të dhënat përpunohen dhe paraqiten si informacion apo të dhëna anonime; realizohen në mënyrë individuale, në zarf të mbyllur.</p> <p>Evidenca 1.20. Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe Ancave për vitin akademik 2022-2023;</p> <p>Evidenca 3.6. Raporti i vlerëimit nga studentët për personelin akademik:</p> <p>Evidenca 6.4. Formular i vetëvlerëimit të stafit:</p> <p>Evidenca 6.12. Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Novacionit për vitin akademik 2022-2023;</p> <p>Evidenca 6.13. Propozim për hapje të programeve të reja:</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>NjBSC ka në përbërje të saj përfaqësues nga secila njësi duke siguruar një gjithëpërfshirje të grupeve të interesit. Ekspertët e jashtëm kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij. Njësia bazë, në hartimin dhe implementimin e programeve të studimit, i përgjigjet standardeve të cilësisë. Në këtë kuadër ajo angazhon dhe ekspertët të jashtëm në hartimin e kurrikulave, shqyrtimin e literaturës apo propozimet për programet e reja të studimit.</p> <p>Evidenca Nr.4.14 Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</p> <p>Evidenca Nr.6.9 Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja;</p> <p>Evidenca Nr.6.13 Propozim për hapje të programeve të reja;</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>WBU përfshin të gjitha njësitë akademike dhe përfaqësuesit e studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Vlerësimi i cilësisë përfshin anëtarët e personelit akademik, administrativ dhe studentët, me të dhëna të përpunuara dhe paraqitura në mënyrë anonime dhe transparente. Ekspertët e jashtëm kontribuojnë në hartimin dhe përmirësimin e programeve të reja të studimit. Raportet e vlerësimit dhe të punës kërkimore-shkencore publikohen dhe shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b></p> <p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë</p>	<p>Veprimtaria e institucionit është transparente për personelin, për studentët dhe të gjitha palët e interesuara. Institucioni zbaton politika transparente për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofron, duke monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit. Kjo realizohet përmes politikave të hartuara nga Komisioni i</p>

<p>transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe NjsBC. Raportet publikohen rregullisht në veb faqen e internetit dhe janë lehtësisht të qasshme. Strukturat drejtuese akademike dhe administrative të Universitetit pas shqyrtimit të tyre japin rekomandime përkatëse.</p> <p>Evidenca 1.4 Plani Strategjik 2023-2030;</p> <p>Evidenca Nr.3.6 Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni ka një politikë si dhe procedura të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore mbi publikimin e materialeve që i referohen veprimtarisë institucionale. Publikimi bëhet në përputhje me rregullat e etikës akademike, parashikimet e Statutit, rregulloreve të brendshme dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat përpunohen në formën e një raporti, i cili i vëhet në dispozicion personelit.</p> <p>Evidenca Nr.6.14-Kodi i Etikës për Stafin Akademik dhe Administrativ;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në kaudrin e proceseve të vlerësimit të brendshëm hartohen raporte vjetore në nivel institucional. Në këto raporte pasqyrohet vlerësimi mbi rezultatet e aritura nga institucioni për veprimtarinë akademike si dhe adresohen rekomandimet mbi mangësitë e evidentuara. Këto rekomandime u adresohen strukturave të caktuara me sigurrimin e cilësisë të cilat, në kuadrin e strategjive për përmirësimin e cilësisë, hartojnë edhe plane konkrete për masat që do të ndërmeren me qëllim arritjen e objektivave që i referohen cilësisë.</p> <p>Evidenca 1.9. Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;</p> <p>Evidenca 3.14. Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU;</p> <p>Evidenca 3.15. Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU;</p> <p>Evidenca 3.3. Pyetësor për vlerësimin e nevojave për trajnime nga personeli akademik;</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me aktet e tij rregullatore, institucioni vlerëson efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive të ndërmara në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik zhvillohen ditët orientuese që kanë për qëllim lehtësimin e integritit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ. Në këto takime prezantohet organizimi i institucionit, detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave dhe njësisë të ndryshme, ecuria e proceseve në të cilat është përfshirë universiteti, si edhe objektivat dhe synimet për vitin e ri akademik.</p> <p>Evidenca Nr.3.2-Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Infromimi i studentëve dhe stafit akademik mbi proceset e sigurimit të cilësisë mundësohet së pari për shkak të shkallës së gjerë të përfshirjes dhe përfaqësimit në strukturat institucionale me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë si NJSBC apo Senatit Akademik. Institucioni ka krijuar një sërë metodash e mjetesh për informimin e të gjithë të interesuarve mbi proceset e sigurimit të cilësisë. Për studentët dhe stafin akademik janë hartura udhëzues e manuale të veçanta mbi strukturat e mekanizmat e cilësisë. Informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimit të raporteve të vlerësimit të cilësisë dhe informacioneve në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Rritja e ndërgjegjësimit të studentëve mbi rëndësinë e përfshirjes në sigurimin e cilësisë të programit të studimi mundësohet edhe nëpërmjet angazhimit të studentëve në Këshillat Studentorë apo Klubet Studentore ku studentët marrin pjesë aktive.</p> <p>Evidenca 1.9. Lista e trajnimeve të zhvilluar për stafin gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor;</p> <p>Evidenca 6.15. Takimet e zhvilluara me maturan të në WBU;</p> <p>Evidenca 6.16. Promovimi i Universitetit Western Balkans në panairine organizuar nga MAS;</p> <p>Evidenca 6.17. Organizimi i Samitit të inovacionit;</p> <p>Evidenca 6.18. Kalendari i mbledhjeve i organeve kolegjiale;</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>WBU siguron transparencë në veprimtarinë e vet për personelin, studentët dhe palët e interesuara. Institucioni bën publike rezultatet e çdo programi, duke respektuar</i></p>



	<p><i>legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe etikën akademike.</i></p> <p><i>WBU organizon ditë orientuese dhe veprimtari periodike për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve për përmirësimin afatgjatë të cilësisë, dhe zhvillon trajnime të rregullta bazuar në nevojat e identifikuara për trajnimin e personelit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në:  
“Menaxhim Spitalor”**

**a. Pikat e forta:**

1. Universiteti ju ofron studentëve mundësi të shumta për zhvillimin e praktikave për shkak të marrëveshjeve me rrjetin e spitaleve Amerikan;
2. Programi është vazhdim i bachelor në “Menaxhim i kujdesit shëndetësor”;
3. Mësimdhënia është në gjuhën angleze, dhe ka student nga vende jashtë Shqipërisë;
4. Pjesë e personelit akademik janë stafet të rrjetit spitalor Amerikan c’ka ndihmon shumë në sjelljen e eskperiencës dhe transmetimin e saj tek studentët;
5. Infrastruktura laboratorike me laborator digjitale;
6. Biblioteka e pasur me 30,000 tituj botime të shtëpive botuese prestigjioze (Springer, Taylor and Francis, Willis,) abonimi në JSTOR dhe Research4Life, si dhe mundëson 36 burime online, të qasshme në <https://library.WBU.edu.al/>;

**b. Pikat e dobëta:**

1. Në disa syllabuse titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor sipas Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 59 “Kategoritë e personelit akademik”; (*Standarti II.3, kriteri 4*)
2. Janë prezent disa lektorë që nuk përmbushin detyrimin ligjor për të patur kualifikim të ciklit pasardhës; (*Standarti IV.1, kriteri 1*).
3. Në lëndën “Menaxhimi i pacientit dhe kujdesi spitalor” pedagogu i lëndës nuk është i fushës së mjeksisë; (*Standarti IV.1, kriteri 1*).

**Rekomandime:**

1. Institucioni duhet të rishikojë titullarët e lëndëve dhe emërtimi nga kategoria “Profesor”;
2. Institucioni duhet të marrë masa për të mbuluar të gjithë mësimdhënien e programit të studimit me personel akademik me së paku me gradën “Dr”, sipas akteve ligjore në fuqi;
3. Institucioni duhet caktojë një profesionist mjekësor të jetë bartës i lëndës “Menaxhimi i Pacientit dhe Kujdesi Spitalor”.

**Evaluation's conclusions for the second level of study Master fo Science in "Hospital Management"**

**a. Strengths and affirmations:**


1. University provide students with opportunities for attending professional practice because of agreements with American Hospital chain;
2. MSc program is continuous of bachelor program "Management and healthcare service;
3. Program is delivered in English and there are enrolled students from abroad;
4. A part of academic staff are part of American hospital chain, thus bringing experience and transfer it to students;
5. Very good laboratory infrastructure and digital labs;
6. Library has 30,000 titles of well-known publishing house like: Springer, Taylor and Francis, Willis etc, subscription on JSTOR and Research4Life, and enable 36 online sources, accessible on <https://library.WBU.edu.al/>.

**b. Weaknesses:**

1. There are some subject titular of syllabus who are not of professor category, according to Article 59 of the Law no. 80/2015 "For Higher education in Albanian republic; (*Standard II.3, criteria 4*)
2. Engagement in teaching process of this program even academic staff with Msc grade, which is not in accordance with Article 59/6 of the Law no. 80/2015, whcih defines proper level of academic qualification. (*Standard IV.1, criteria 1*).
3. There is a subject "Patient management and hospital care" is covered form an academic staff of the health area (*Standard IV.1, criteria 1*).

**Recommendations:**

1. Institution should review some subject titular and appoint academic staff with "Professor" category;
2. Institution should engage in teaching process only academic staff with PHD grade, in accordance with requirements of the legal framework for proper acidic qualification;
3. Institution should appoint a health professionalist to deliver subject "Patient management and hospital care".





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

